BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS
THE NATIONAL AND UNIVERSITY LIBRARY OF KOSOVA

JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË
LIBRARY WEEK IN KOSOVA

14 - 19 PRILL - APRIL 2009

Prishtinë
2009

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës
Botime të Veçanta: JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË, 6

•

LIBRARY WEEK IN KOSOVA
14 - 19 PRILL - APRIL 2008

Botues:
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Kryeredaktor i botimeve:
Prof. Dr. Sali Bashota

Këshilli redaktues:
Fazli Gajraku
Besim Kokollari
Bukurije Haliti

Dizajni dhe realizimi kompjuterik:
Hekuran Rexhepi

BKUK Botime të Veçanta; 15: Java e Bibliotekës në Kosovë 2008; 6

BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS

THE NATIONAL AND UNIVERSITY LIBRAY OF KOSOVA

JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË

•

LIBRARY WEEK IN KOSOVA

14-19 PRILL – APRIL 2008

6

Prishtinë, 2009

Përmbajtja

Hyrje 7
HYRJE 7

Fjalë urimi **11**
JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË 2008 11
Dr. Sali Bashota
NDËRTIMI I SHTETIT ME VLERAT DHE TRADITAT MË TË MIRA TË NJERËZVE TË TIJ 15
Alex Laskaris

Bibliotekat & Themeluesit **19**
THE LIBRARY & FOUNDERS 19
A short history of the role of information in the founding of the USA
Karen Coyle

Bibliotekat digjitale **21**
BIBLIOTEKA DIGJITALE - REALITET HYRJEJE EDHE PËR KULTURËN SHQIPTARE 21
Etleva Domi

Bibliotekat publike në epokën digjitale **51**
DOMOSDOSHMËRIA E NJË STRATEGJIE KOMBËTARE PËR BIBLIOTEKAT PUBLIKE NË EPOKËN DIGJITALE 51
Ramazan Vozga

Biblioteka digjitale dhe kujtesa kombëtare **59**
BIBLIOTEKA DIGJITALE NË SHËRBIM TË KUJTESËS KOMBËTARE 59
Besim Kokollari & Ramush Zeka

Biblioteka midis tradicionales dhe digjitales **69**
BIBLIOTEKA NË SHEK. XXI, MES TRADICIONALES, AUTOMATIZIMIT DHE DIGJITALES 69
MA. Gjon Berisha

Procesi i digjitalizimit në BKUK **83**
BIBLIOTEKAT DIGJITALE - PROCESI I DIGJITALIZIMIT NË BKUK 83
Lavdie Rrahmani

Bibliotekat digjitale **89**
DIGITAL LIBRARIES 89
Karen Coyle

Digjitalizimi i arkivave **97**
DIGITIZING ARCHIVES 97
Karen Coyle

Fjalë promovimi **105**
KËNDI AMERIKAN PËR QASJE NË INFORMATA DHE PROGRAME TË NDRYSHME ZHVILLIMI 105
Alex Laskaris

Bibliotekaria në Kosovë **107**
BIBLIOTEKAT - TEMPUJT TË VLEFSHËM TË NJË KOMBI 107
Shefki Osmani
BIBLIOTEKAT PËRBALLË SFIDAVE 111
(Me vështrim të veçantë në Kosovë)
Mr. Tahir Foniqi

DHJETË KRITERET PËR PASURIMIN E KOLEKSIONEVE TË BIBLIOTEKAVE 117
Sylejman Pireva
DISA ÇËSHTJE ME RËNDËSI NË NDËRTIMIN DHE ZHVILLIMIN E FONDEVE LIBRARE NË KOSOVË 121
(Realiteti dhe perspektiva)
Hajrullah Mustafa
TEMATIKA E BOTIMEVE NË KOSOVË GJATË VITIT 2007 127
Shqipe Asllani &Shkëndije Berisha
BIBLIOTEKARIA SHQIPTARE NË LUGINËN E PRESHEVËS 131
Xhemaledin Salihu
BIBLIOTEKAT E BURGJEVE 139
Avdi Lakna

Bibliotekat në internet 145
LIBRARIES IN THE WEB 145
Karen Coyle

Tendencat në sistemet e bibliotekave 163
TRENDS IN LIBRARY SYSTEMS 163
Karen Coyle

Hyrje

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës bashkë me Ambasadën Amerikane në Prishtinë, organizuan Edicionin e gjashtë - *Java e Bibliotekës në Kosovë 2008*, që është ngjarja më e rëndësishme e vitit për kulturën dhe bibliotekat në Kosovë. Në këtë manifestim për Librin dhe Bibliotekat, që u mbajt në Prishtinë, Prizren dhe Gjilan, u zhvilluan aktivitet të rëndësishme kulturore: seminare, ligjërata, ekspozita, promovime, donacione, përurime.

Gjatë kësaj Jave, u organizua *Dita e Dhurimit të Librit*, në të cilën donatorë nga Kosova dhe nga jashtë i dhuruan Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës: libra, revista, dorëshkrime dhe materiale të ndryshme me rëndësi kulturore.

Gjatë Javës së Bibliotekës në Kosovë u nënshkrua *Akti i Ri i Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë*; u promovua Projekti "*Kujtesa e Kosovës"*, libri i Eqrem Çabejit *Hyrje në Indoeuropianistikë* - me leksione të mbajtura në Universitetin e Prishtinës, si dhe u promovuan libra të botuar nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës.

Gjatë Javës u përurua edhe *Biblioteka e Fakultetit të Filologjisë*, si dhe u implementua për herë të parë *Programi i Automatizuar Bibliotekar Aleph 500* në disa nga bibliotekat ndërkomunale të Kosovës.
Në Edicionin e gjashtë të Javës së Bibliotekës, u bë përurimi i bibliotekës: Këndi Amerikan, i cili, pos që ofron koleksione të pasura nga literatura amerikane të fushave të ndryshme edukative dhe shkencore, ofron edhe rol shumë të rëndësishëm për shkollimin e studentëve të Kosovës në universitet amerikane.
Në Edicionin e gjashtë të *Javës së Bibliotekës në Kosovë* morën pjesë ekspertë ndërkombëtarë nga fusha e bibliotekarisë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vende të tjera, si dhe ekspertë vendës, të cilët shkëmbyen përvoja dhe ide të rëndësishme që shpalosin projektet e të ardhmes së bibliotekave në Kosovë.
Në Javën e Bibliotekës në Kosovë, gjithashtu, morën pjesë përfaqësues të njohur të kulturës, përfaqësues të zyrave diplomatike në Prishtinë, si dhe personalitete kulturore e politike të rëndësishme të Kosovës e të Shqipërisë.

Gjatë kësaj *Jave* ligjërata të veçanta, që zgjuan interesim në opinionin kulturor bibliotekar, ishin ato të znj. Karen Coyle, konsultante për Bibliotekat Digjitale në Universitetin e Kalifornisë në SHBA, si: "Roli i bibliotekave në themelimin e SHBA-ve", "Bibliotekat digjitale - Si të përdoren mënyra digjitale për ruajtjen dhe katalogimin e librave të rrallë dhe të vjetër", "Sistemi i automatizuar bibliotekar", "Rrjeti si platformë - Bibliotekat Universitare (Modeli i Bibliotekës Amerikane, platforma e rrjetit)".
Tema nga fusha e bibliotekarisë, me përqendrim te aktualitetet nga kjo fushë në realitetet tona, u dhanë në ligjëratën me titull "Bibliotekat digjitale", që u mbajt në Prizren, ku referuan ekspertë nga Kosova dhe Shqipëria: Etleva Domi, Ramazan Vozga, Ramush Zeka, Gjon Berisha dhe Lavdije Rrahmani.

Po ashtu, pati diskutime në temën "Bibliotekaria në Kosovë" - e organizuar në Gjilan, në të cilën referuan disa nga drejtuesit e Bibliotekave Ndërkomunale, si dhe punëtorë të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës: Shefki Osmani, Tahir Foniqi, Sahadete Sadikaj, Sylejman Pireva, Hajrullah Mustafa, Shqipe Asllani, Shkëndije Berisha, Xhemaledin Salihu dhe Avdi Lakna.
Në këtë botim përfshihen të gjitha ligjëratat dhe diskutimet të cilat janë arkivuar në formë të punimeve të dorëzuara me shkrim - qoftë në formë të zgjeruar qoftë në formë të abstrakteve, dhe të cilat me vlerën e tyre hulumtuese dhe të paraqitjes së opinioneve, janë të rëndësishme për shumë nga çështjet që i preokupojnë drejtuesit dhe punëtorët e bibliotekave në kontekstin tonë aktual dhe të perspektivave nëpër të cilat po ecën bibliotekaria në këtë periudhë.

JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË 2008

Dr. Sali Bashota*

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, tashmë i ka dy manifestime më të rëndësishme brenda një viti, të cilat i kanë shenjat e veta autentike në kalendarin e veprimtarive të veçanta kulturore. Këto janë: **Java** e **Bibliotekës në Kosovë,** e cila që nga viti 2003, organizohet bashkë me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë dhe aktiviteti tjetër **Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë**, e cila që nga viti 2006, organizohet bashkë me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë. Gjithsesi, pra këto dy veprimtari tashmë janë bërë ngjarje të veçanta kulturore për librin dhe bibliotekat e Kosovës.

Edicioni i gjashtë i Javës së Bibliotekës në Kosovë, i cili edhe sivjet koincidon si gjithnjë me **Javën e Bibliotekës** në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vazhdon të frymëzohet nga modeli

* Dr. Sali Bashota është drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Ky fjalim është prezantuar më 14 prill 2008, me rastin e hapjes solemne të Edicionit të gjashtë - Java e Bibliotekës në Kosovë.

amerikan për rolin dhe misionin që e kanë bibliotekat në shoqërinë demokratike, për të sensibilizuar institucionet qeveritare për një përkushtim edhe më të madh për funksionimin e sistemit të bibliotekave të Kosovës.
Pra, **Java e Bibliotekës në Kosovë** është një aktivitet kulturor, i cili pasurohet vazhdimisht me programe të caktuara profesionale për zhvillimin e bibliotekave, duke i artikuluar idetë dhe përvojat më të reja që kanë të bëjnë me format e komunikimit në botën e librit dhe të informacionit modern.
Aktivitetet e kësaj **Jave** në këtë vit do të përqendrohen në Prishtinë, Prizren dhe Gjilan , ku do të ketë ligjërata, sesione shkencore, seminare, ekspozita, promovime, donacione për bibliotekat etj., të cilat pikësynim kryesor do ta kenë: përkrahjen për bibliotekat.

Duke e mbështetur fuqishëm me ekspertë të njohur amerikanë, si dhe duke dhënë ndihmë të pakursyer në vazhdimësi projekteve më të rëndësishme të BKUK-së, Ambasada e SHBA-ve në Prishtinë, gjithsesi, është bërë një ndër mbështetësit kryesor në nxitjen, afirmimin, stimulimin e projekteve që kanë të bëjnë me veprimtarinë e BKUK-së, por edhe të bibliotekave tjera në Kosovë.

Në edicionin e gjashtë të Javës së Bibliotekës, në qendër të aktiviteteve do të jenë: përurimi i bibliotekës: Këndi Amerikan, pastaj ligjëratat e veçanta të znj. Karen Coyle, Konsultante për Bibliotekat Digjitale në Universitetin e Kalifornisë në SHBA, nënshkrim i Aktit të ri të Marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, themelimi i qendrës dokumentare: Kujtesa e Kosovës, përurimi i Bibliotekës së Fakultetit të Filologjisë, zhvillimi i projektit për sistemin e automatizuar bibliotekar Aleph 500 në bibliotekat e Kosovës, përurimi i veprës studimore të Eqrem Çabejt, dita e donacioneve etj.

Këto projekte, ndër të tjera, do të ndihmojnë edhe në përcaktimin e rrugës së zhvillimit dhe afirmimit të BKUK-së, por edhe të bibliotekave tjera të Kosovës, duke e dalluar dhe çmuar kontributin e tyre në ndërtimin e një shoqërie demokratike, e cila synon dhe bazohet, para së gjithash, në dije dhe në vlera të dëshmuara për një të ardhme edhe më të ndritur në të gjitha fushat e jetës.

Gjithsesi, përurimi i **Këndit Amerikan** në kuadër të BKUK-së, është njëra ndër ngjarjet më të gëzuara për punëtorët e Bibliotekës, dhe në veçanti për lexuesit, të cilëve u ofrohet literaturë amerikane nga fusha të ndryshme edukative dhe shkencore. **Këndi Amerikan** me koleksionet e tij, si deri më tani, por edhe në të ardhmen do të ketë rol shumë të rëndësishëm, sidomos për edukimin dhe ofrimin e njohurive më të reja shkencore për studentët e Kosovës.

Pra, **Java e Bibliotekës në Kosovë,** do të pasurohet me ligjëratat dhe udhëzimet e ekspertes nga SHBA, që kanë të bëjnë me bibliotekat digjitale dhe me rolin e bibliotekave në themelimin e SHBA-ve , ndërsa dy sesionet me karakter shkencor të ligjëruesve nga Shqipëria dhe Kosova, ku do të paraqiten tema me interes për bibliotekat, pritet që të sjellin kontribute në artikulimin e ideve teorike që kanë të bëjnë me zhvillimet moderne të bibliotekave shqiptare, apo edhe me situatat e ballafaqimit të realitetit të tyre sot.

Në kuadër të këtij manifestimi, më në fund, po fillon të realizohet projekti **Kujtesa e Kosovës**, duke synuar që të zhvillohet sipas modelit American Memory (Kujtesa Amerikane) i Bibliotekës së Kongresit Amerikan, i cili është njëri ndër projektet më kapitale që mund të determinojë rolin dhe misionin e historisë, kulturës, qytetërimit, identitetit, shëmbëlltyrave, personaliteteve, trashëgimisë gojore, trashëgimisë së shkruar etj., më në fund për të dokumentuar dhe ruajtur këtë kujtesë.

Me fillimin e këtij projekti Biblioteka Kombëtare dhe Universitare do të bëhej një pikë referimi i kujtesës së Kosovës, në bashkëpunim edhe me institucionet tjera shkencore, kulturore, arsimore etj., për të krijuar një koleksion dokumentar digjital, i cili nuk do të mbështetej vetëm në burimet e komunitetit kosovar, por edhe më gjerë, ato burime që ndërlidhen me Kosovën, me të kaluarën, tashmen dhe të ardhmen e saj.
Edhe projektet e tjera, siç janë: Biblioteka e Fakultetit të Filologjisë, sistemi i automatizuar bibliotekar Aleph 500, kanë për qëllim kryesor t'i funksionalizojnë aktivitetet, veprimtaritë, perspektivën e bibliotekave në Kosovë.
Institucionet qeveritare të Republikës së Kosovës dhe në këtë drejtim Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë kanë treguar mirëkuptim të vazhdueshëm me shumë aktivitete mbështetëse, por bibliotekat në Kosovë ende kanë shumë nevojë për përkrahje në pasurimin e fondeve, në zhvillimin e koleksioneve, në modernizimin e tyre sipas standardeve ndërkombëtare.
Në fund dëshiroj të falënderoj Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, stafin drejtues të saj për kontributin e pakursyer dhënë zhvillimit të shumë projekteve të BKUK-së këtyre viteve të fundit.
BKUK është mirënjohëse edhe shumë institucioneve të Republikës së Kosovës dhe atyre ndërkombëtare, të cilat kanë kontribuar në forma dhe mënyra të ndryshme për bibliotekat.

Besojmë dhe shpresojmë se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, bashkë me Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, do të kontribuojnë më fuqishëm në zhvillimin dhe përparimin e bibliotekave të Republikës së Kosovës.
Manifestimi **Java e Bibliotekës në Kosovë**, le të jetë çelja e këtij shtegu për t'i përmbushur detyrimet ndaj librit dhe bibliotekës.

NDËRTIMI I SHTETIT ME VLERAT DHE TRADITAT MË TË MIRA TË NJERËZVE TË TIJ

Alex Laskaris*

Në emër të Ambasadës Amerikane dhe Shefes së Misionit Tina Kaidanow, kënaqemi dhe nderohemi që marrim pjesë në përvjetorin e gjashtë të Javës së Bibliotekës.

Dy muajt e fundit kanë qenë vërtet historike dhe populli i Kosovës edhe një herë i tregoi botës se ka pranuar privilegjet dhe përgjegjësitë e pavarësisë.

Tani ka shumë sfida përpara, por ato nuk janë më sfida për të fituar pavarësinë. Ato janë sfida më të vështira, për të ndërtuar shtetin, i cili pasqyron vlerat dhe traditat më të mira të të gjithë njerëzve të tij dhe ndërtimin e asaj të cilën Abraham Linkolni e quajti "paqe e drejtë dhe e përhershme ndërmjet nesh me të gjithë popujt".

* Alex Laskaris, zëvendës-shef i Misionit të Ambasadës së SHBA-ve në Prishtinë. Ky fjalim është prezantuar më 14 prill 2008, me rastin e hapjes solemne të Edicionit të gjashtë - Java e Bibliotekës në Kosovë. Titulli i këtij punimi është i redaksisë.

Ne jemi shumë optimist për Kosovën, sepse edhe ne dikur kemi qenë shtet i ri, që u ballafaqua me çështjet themelore, si të qeverisim vetveten dhe përpjekjet për të ndërtuar institucionet e shtetit të ri.

Njëra ndër këto institucione ishte biblioteka e dedikuar për t'u shërbyer kërkesave të Kongresit të ri.

Biblioteka e Kongresit u themelua në vitin 1800 dhe u dhanë 5,000 $ për të filluar koleksionin. Deri në gusht të vitit 1814 biblioteka e parë u vendos në Capitol-in e ri. Biblioteka u dogj prej trupave britanike. Në të njëjtën kohë ata dogjën edhe kryeqytetin.

Brenda një muaji, ish-presidenti Thomas Jefferson shiti bibliotekën e tij personale si zëvendësim. Jefferson kishte kaluar 50 vite duke mbledhur libra. Koleksioni i tij u konsiderua më i miri në Shtet e Bashkuara.

Në janar të vitit 1815, Kongresi pranoi ofertën e Jeffersonit, duke caktuar $20,000 dollarë për 6.000 librat e tij dhe kështu u vu themeli për bibliotekën e madhe kombëtare. Koncepti Xhefersionian i univerzalitetit, besimi se të gjitha janë të rëndësishme për bibliotekën e popullit amerikan është filozofia dhe kuptimi që qëndron pas politikës së koleksionimit gjithpërfshirës të Bibliotekës së sotme të Kongresit.

Edhe pse Xhefersoni ishte udhëheqës dhe filozof i mrekullueshëm, ai ishte një biznismen shumë i dobët. Ai e shiti bibliotekën e vet, jo për shkak të patriotizmit por për arsye se ishte i futur në borxhe të mëdha.
Pavarësisht nga kjo, nga një bibliotekë e thjeshtë personale e një njeriu, u rrit në një koleksion prej diku rreth njëqind e tridhjetë milionë veprash.

Përveç që kam dashuri të veçantë ndaj historisë amerikane, po i ndaj këto mendime sepse:
Të gjitha shtetet sikur të gjitha bibliotekat i shërbejnë krejt popujt. Ajo duhet të jetë një përmbledhje e të gjitha kujtimeve të tyre, të gjitha traditave të tyre, të gjitha vuajtjeve dhe gëzimeve të tyre. Ajo duhet të ruajë të kaluarën, por gjithashtu të ofrojë një vizion për një të ardhme më të mirë.

Na vjen shumë mirë që Zonja Karen Coyle nga Universiteti i Kalifornisë është këtu që t'u ndihmojë juve të lidheni në teknologjinë moderne për ruajtjen e trashëgimisë së Kosovës dhe nderohemi me këtë bibliotekë dhe me shumë gjëra të tjera që populli i Kosovës na pranon si një partner dhe si një mik.

Ne ju dëshirojmë sukses të vazhdueshëm në ndërtimin e bibliotekës suaj, dhe shpresojmë se do të shndërrohet në njërën prej institucioneve të reja që do t'i shërbejë popullit të Kosovës.

THE LIBRARY & FOUNDERS

A short history of the role of information in the founding of the USA

Karen Coyle*

U S of A
The United States of America

new country
Was founded as a new country in 1776 on the continent of North America.

without mass media
This was an era without mass media, in a geographically large area with a small population.

informed populace
The founders of the nation believed strong that an informed populace

* Karen Coyle është konsultante për Bibliotekat Digjitale në Universitetin e Kalifornisë në SHBA. Ky abstrakt është përmbledhje e një artikulli më të gjerë të prezantuar më 14 prill 2008, në Prishtinë, në manifestimin Java e Bibliotekës në Kosovë.

democracy
… was necessary for democracy.
informed government
They also believed in an informed government…

science
… that promoted science…

industry
… industry …

business
… and business.

information retrieval
They were facing an interesting problem of information retrieval…

information delivery
… and information delivery.

2
Two institutions aided the new government.

1) The postal service
1) The postal service

2) The Library of Congress
1) The Library of Congress



1737
The postal service was begun in 1737 by the British government which ruled the colonies in North America. Benjamin Franklin was the first postmaster.



1774
Franklin was dismissed from his British post in 1774 for "revolutionary activity," at which he was quite successful…



1776
… because shortly afterward, the new country was born.



1790 Postal Act
In 1790, Thomas Jefferson, Secretary of State, signed the Postal Act.



newspapers

Under this act, newspapers, the primary communication of information to citizens, as well as the main outlets for political speech, were mailed at low rates to encourage this communication channel.

private communication

In addition, postal communication was declared to be private, so that people could write and read freely without fear.





"I cannot live without books."

Jefferson was also a great lover of books. At the time, books primarily cam from Europe, and were rare and precious in the new world.

1800

A library was founded in 1800 by Congress to give legislators access to information. This was the beginning of the Library of Congress.

1814

The library was burned to the ground in 1814 by British forces during the War of 1812.



Thomas Jefferson then offered the over 6.000 books of his personal library to rebuild the Library of Congress.

sciences; philosophy; histori; literature

His collection covered every topic imaginable, not just law. This was his view of the information needed in the New World. Much of his original library has been preserved and is on exhibit at the Library of Congress.

Today
Today…

The Library of Congress is one of the largest libraries in the world with around 130 million items (books, manuscripts, films, etc.)

… things are very different. Mail is delivered electronically, radio and television bring the news, and libraries are a mixture of books and computers.

information
This is a world in which information …

communication
… and communication are absolutely vital for civic life.

Library of Congress

Congress
It still reports to and serves Congress. The Library conducts research for
members of Congress so that they are informed in their efforts.

nation
It also serves the nation in many ways.

It is the nation's archive for history ….



… and culture.



It also provides daily updates to citizens on the activities of the legislature and on every bill that is considered, from the time that it is first proposed, through all of its revisions, to the final vote. Although the country spans nearly 5.000 kilometers, everyone has quick access to legislative activity.

past
The key message is that libraries may be an archive of the past…

present
… but their value is in their service to the present ….

future
… and their support of the future of those who use it.

BIBLIOTEKA DIGJITALE - REALITET HYRJEJE EDHE PËR KULTURËN SHQIPTARE

Etleva Domi*

STRUKTURA E PARAQITJES

1. Epoka digjitale
2. Bibliotekat digjitale
    - 2.1 Hyrje
    - 2.2 Burimet elektronike
    - 2.3 Bibliotekari i referencës
3. Nisma botërore
4. Strategjia digjitale e Bibliotekës Kombëtare tëShqipërisë

* Etleva Domi është zëvendësdrejtoreshë e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë. Ky abstrakt është përmbledhje e një artikulli më të gjerë të prezantuar gjatë manifestimit Java e Bibliotekës në Kosovë, më 15 prill 2008 në Bibliotekën Ndërkomunale të Prizrenit në sesionin me temën: “Bibliotekat Digjitale”.

I. EPOKA DIGJITALE

EPOKA DIGJITALE

Mjetet e komunikimit në përgjithësi dhe Interneti-mjeti themelor i akcesit në informacionin e shkruar, të sotëm dhe të ardhshëm, - në veçanti, kanë ndryshuar mjaft dinamikën e sistemit të informacionit. Ato bëjnë të mundur shpërndarjen e menjëhershme të informacionit, lehtësoj në akcesin global në përmbajtje.

EPOKA DIGJITALE

Tanimë shoqëria ka hyrë në epokën lulëzimit digjital, ku spikatin:

I. zhvillimet në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK);

II. referimet digjitale (referimet elektronike);

III. komunikimi digjital.

TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT & KOMUNIKIMIT

Tregues të zhvillimit dhe aplikimit të vrullshëm të teknologjive të reja janë:

• krijimi i "autostradës" informatike;

• krijimi i hipereksteve digjitale;

• zhvillimi spektakolar i siteve web etj.

REFERIMET DIGJITALE

Aplikimi i Teknologjive të Reja të Informacionit dhe Komunikimit po e shton gjithnjë e më shumë gamën e shërbimeve të referimeve digjitale.

"Referimi" mund të përmblidhet në thënien e MontryPython-it:

"Tani, për diçka krejtësisht ndryshe".

Dhe kjo është e lidhur padyshim me Teknologjitë e Reja, çfarë po zbatohen gjithnjë e më shumë në realizimin e bibliotekave digjitale.

BIBLIOTEKAT DIGJITALE

Termi bibliotekë digjitale ose siç njihet ndryshe edhe bibliotekë elektronike apo bibliotekë virtuale, lindi dhe u zhvillua në gjirin e komunitetit të bibliotekarëve në fillim të viteve '60.

Në komunitetin e bibliotekarëve debatohet mjaft për përkufizimin e nocionit "Bibliotekë digjitale".

BIBLIOTEKAT DIGJITALE

Bibliotekat digjitale janë koleksione të organizuara të "përmbajtjeve" të digjitalizuara, të cilat mund të jenë të disponueshme për publikun.

Cili do të ishte përkufizimi termit "Përmbajtje"

"Përmbajtje" mund të jenë:

• kopje të digjitalizuara të librave apo materialeve të tjera "fizike" (dokumente, harta, foto etj.) nga mjaft institucione kulturore (biblioteka, arkiva, muzeume etj.) ose

• objekte digjitale.

OBJEKTET DIGJITALE

Objektet digjitale janë materiale (libra, postera, regjistrime zanore etj.), që janë prodhuar/lindur, krijuar që në origjinë në format digjital dhe nuk ekzistojnë në një formë tjetër fizike.

BIBLIOTEKAT DIGJITALE

Biblioteka digjitale është një hapësirë informacioni, e lirë, që lejon navigim në "objektet digjitale".

Bëhet fjalë për një site Internetim, – një çadër të madhe do të më pëlqente ta quaja, -në të cilën janë mbledhur tekste në formë digjitale.

BIBLIOTEKAT DIGJITALE

- Nuk kanë nevojë për shumë hapësirë fizike: paraqitja e koleksioneve (libra, periodikë, dorëshkrime, harta etj.) realizohet në formë elektronike;
- Në përgjithësi ato përmbajnë tekste të përjashtuara nga të drejtat e autorit - thënë ndryshe që janë në domen publik -dhe janë të tërheqshme falas nga Interneti;
- Rrisin qasjen intelektuale për komunitetinmbarëbotëror nëpërmjet Internetit;
- Ruajnë ekzemplarët origjinalë.

BIBLIOTEKAT DIGJITALE

Pra, përkufizimi i termit "bibliotekë digjitale" do të ishte një kombinim i:

- koleksioneve digjitale;
- burimeve elektronike;
- referimeve digjitale dhe shërbimet digjitale.

BIBLIOTEKAT DIGJITALE

- "Koleksione digjitale" janë "file" që një bibliotekë/institucion ka arkivuar e mund të përdoren nga cilido, por që janë në pronësi të tyre;
- "Burime elektronike" janë "file" të digjitalizuara, që institucioni duhet të abonohet, që të mund t'i shfrytëzojë ato; ato nuk mund të arkivohen në institucione. EBSCO është , siç njihet nga të gjithë, një shembull i "burimeve elektronike".

REFERIMET DIGJITALE

Referimet digjitale (referimet elektronike, referimet virtuale ose referimet online) janë shërbime të kërkuara nëpërmjet Internetit, zakonisht me anë të postës elektronike (e-mail) ose në forma të tjera të bazuara në web.

Përgjigjet përcillet nga departamenti i shërbimeve referuese të një

biblioteke, në mënyrë të pavarur ose nëpërmjet një sistemi të përbashkët që mirëmbahet nga anëtarë të një rrjeti global referimesh.

REFERIMET DIGJITALE

Nëse më pak se një dekadë burimet e informacionit ishin sinonime me librin dhe shtypin, sot ky përcaktim ka të bëjë me botën digjitale, botën elektronike.

Referenca digjitale është një zgjerim i shërbimit referues tradicional i ofruar në shumicën e bibliotekave.

Në këtë rast përdoruesi mund të pyesë edhe në distancë. Bibliotekari mund të përgjigjet me telefon, fax, e-mail ose i thotë të interesuarit të paraqitet në bibliotekë për gjetjen e përgjigjes.

SHËRBIME DIGJITALE

Me shërbim digjital/komunikim digjital kuptojmë transferimin e informacionit nga një vendndodhje fizike tenjë tjetër nëpërmjet mjeteve elektronike.

Shërbimi më popullor në Internet, pas postës elektronike (e-mail-it), është Pyet për shërbime.

Komunikimi i të dhënave mundëson shkëmbimin e të dhënave në pak sekonda me një të klikuar të mouse-it.

BIBLIOTEKARI I REFERENCËS

Bibliotekari i referencës duhet:

- Të njohë metodat e kërkimit, që të mund të orientohet në"autostradën informative";
- Të jetë i familjarizuar me burimet digjitale;
- Të jetë bibliotekar profesionist;
- Të ndjehet mirë përpara kompjuterit;
- Të ketë njohuri mjaft të mira për bazën elektronike të të dhënave, që të jetë në gjendje të përzgjedhë prej saj.

BIBLIOTEKAT DIGJITALE PËRDORUESI

- Për të kërkuar në katalog dhe për të lexuar materialin nuk është e nevojshme që lexuesi të shkojë në bibliotekë;
- Materiali mund të lexohet dhe/ose shkarkohet nga Interneti edhe nga kompiuteri i shtëpisë;
- Materiali është i disponueshëm për lexuesit mbarëbotëror.

DËSHMITË DHE PROVAT

Dhe tanimë bota e teknologjive informatike këtë "thesar të paprekur e të fshehtë" e kanë bërë "të rrokshëm".
Dëshmitë e provat e bibliotekave digjitale i kemi në duar.

DËSHMITË DHE PROVAT

Në nivel botëror projekti më i gjerë që gjendet në rrjet është projekti amerikan **Gutenber**g - nisur që në vitin 1971, projekti **Perseus** (1987), projekti **Runeberg** (1992), Alex, On-line Book Page, Internet Book Information Center, Oxford Text Archive etj. vijuar së fundmi me projektin e BiIbliotekës Digjitale Botërore.
Në nivel evropian mund të përmendim projektin Manuzio (1993), i cili ofron falas thesaret e letërsisë italiane; Archivi del'900, Vasari, Duecento, Biblio F451,CiBit, Freinet etj., që ofrojnë tekste të rralla, vijuar së fundmi me MICHAEL, BRICKS, TEL, EUROPEANA etj.

II. NISMA BOTËRORE

BIBLIOTEKA DIGJITALE EUROPIANE

Mendimi që udhëhoqi nismën i2010 të Komisionit Europian për një shoqëri europiane të informacionit ishte për të mundësuar një jetë më të mirë për cilindo. Prandaj kur flitet për një Shoqëri Informacioni, nuk jemi të interesuar vetëm për pajisje, por shërbime për përdorues dhe qytetarë.

BIBLIOTEKA DIGJITALE EUROPIANE

Një ndër objektivat kryesore të ndërmarrjes së këtyre nismave, që mbështetet edhe nga Komisioni Europian, është krijimi i "Bibliotekës Digjitale Europiane", e cila do t'i mundësojë të gjithë qytetarëve, -si një e drejtë themelore e tyre (Deklarata e të Drejtave të Njeriut), - që të kenë qasje të drejtpërdrejtë nga kompjuterat e tyre, në koleksionet kulturore të të gjithë shteteve anëtare.
Biblioteka Digjitale Europiane do të jetë pikë ideale e hyrjes në materialin e digjitalizuar, jo vetëm të bibliotekave, por edhe arkivave, muzeumeve e institucioneve të tjera kulturore.

BIBLIOTEKA DIGJITALE EUROPIANE

Europa ka një trashëgimi kulturore mjaft të pasur që gjendet në biblioteka, arkiva dhe muzeume të të gjitha kontinenteve.
Vetëm digjitalizimi dhe mundësia e shfrytëzimit online të koleksioneve do të mund t'i bëjë ato më të akcesueshme për qytetarët e Europës.

NISMA E FUNDIT:
PROJEKTI EUROPEANA
SFIDAT

Sot është bërë fakt, që bibliotekat kombëtare, që tradicionalisht kanë grumbulluar, ruajtur dhe shërbyer shtypshkrime, aktualisht po përballen edhe me sfidën e mbledhjes së burimeve digjitale dhe/ose krijimin e tyre, ruajtjen dhe vënien në rrjetin digjital global. Modelet i kemi tanimë në duar. Bibliotekat Kombëtare kanë qenë pioniere të zbatimit të bibliotekave digjitale.

NISMAT TË BIBLIOTEKAVE KOMBËTARE

Nisma "kanë shpërthyer" e "mbërthyer" mbarë botën.
Ato synojnë që të mundësojë lehtësisht akcesin në trashëgiminë globale -në kultura e gjuhë të ndryshme për publikun kulturor mbarëbotëror.
Modelet e bibliotekave digjitale, realizuar nga bibliotekat kombètare i kemi në duar.

KUJTESA AMERIKANE

Kujtesa Amerikane ("AmericanMemory") -e para bibliotekë digjitale (realizuar nga një bibliotekë kombëtare), krijuar që më 1995

me nismën e Bibliotekës së Kongresit, mundëson qasje në pasuritë e papërshkrueshme të koleksioneve arkivore, duke filluar që nga librat, pamfletet, hartat, revistat, gazetat etj. dhe vijuar deri te videot, filmat e regjistrimet zanore.

GALLICA, GALLICA 2.0

Nismë e ngjashme e përmasave gjigande është edhe projekti i Bibliotekës Kombëtare të Francës *Gallica,* vijuar së fundmi me *Gallica 2.0 (përditësim i Gallica),* që mund të quhet pa hezitim një model për të ardhmen e një bibliotekë digjitale europiane.

TEL (The European Libraries)

Duke synuar krijimin e një portali që të mundësojë lehtësisht akcesin në trashëgiminë kulturore të bibliotekave europiane - në kultura e gjuhë të ndryshme -për publikun kulturor mbarëbotëror,

CENL-ja ndërmori nismën e projektit TEL.
TEL (The European Libraries) si një shërbim online nisi në mars të vitit 2005.
Ai mundëson akces pa pagesë në katalogët online dhe koleksionet e digjitalizura tëbibliotekave kombëtare – vendeve anëtare në Këshillin e Europës;
Për zgjerimin e akcesit, janë ndërmarrë, nisma të tilla si:
TEL-ME-MOR (2005-2007)
EDL (2006-2008)
TELplus (2007-2009)
FUMAGABA (2008-2009) etj.

BIBLIOTEKA DIGJITALE BOTËRORE

Sot numërohen mjaft projekte të përbashkëta digjitalizimisi në SHBA dhe Europë, ashtu edhe në Australi e Azi.
Duke synuar ofrimin online të koleksioneve të rralla të SHBA, Europës dhe kontinenteve të tjerë, promovimin ndërkulturor dhe ndërgjuhësor, Biblioteka e Kongresit dhe UNESCO, duke marrë në konsideratë faktin që trashëgimia digjitale është shtuar mjaft dekadat e fundit, janë marrë vesh që të bashkëpunojnë për hartimin/zhvillimin e paketave me udhëzues për
Bibliotekën Botërore Digjitale -si urë komunikimindërmjet kulturave (2007).
III. Cila është strategjia e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë?

AUTOMATIZIMI I BK

- Kompjuteri i parë ka hyrë në vitin 1990;
- Në vitin 1994 në BK u instalua programi bibliotekar CDS/ISIS dhe filloi katalogimi në një sistem të automatizuar i hyrjeve të reja. Ky vit shënon fillimet e krijimit të skedarit elektronik;

- Në vitin 1998 u krijua rrjeti lokal (LAN);
- Në vitin 1999 u instalua programi bibliotekar ADLiB;
- Në vitin 2000 u konvertua baza e të dhënave ngaCDS/ISIS në softin e ri bibliotekat ADLib.
- Aktualisht të dyja bazat e të dhënave janë integruar në sistemin e ri.

WEBSITE-i i BK-së

Ofron:
- Informacion për bibliotekën dhe koleksionet e saj;
- Portale në burime të tjera Interneti;
- OPAC-un.

http:// www.bksh.al http:// www.bksh.al

BAZA E TË DHËNAVE

Tanimë është krijuar baza e të dhënave elektronike për botimet shqiptare dhe të huaja, e cila përmban 229.510 regjistrime:
- Libra 37.386
- Artikuj 189.835
- Disertacione 958

• Harta 107
• Seriale 1.193
• Materiale audio-vizuale 31

Baza e të dhënave mund të shfrytëzohet si në mjediset e BK, ashtu edhe jashtë mureve të saj.
http://www.bksh.al/Katalogu/library/wwwopac/wwwroot/beginner/index_gb.html



Në një kohë si kjo që po jetojmë, kur përditë flitet e shpresohet për integrime në rrjedhat europiane, a nuk duhet që dhe bibliotekat kombëtare të shtyhen për t'u përfshirë në të tilla projekte e nisma eropiane? Them se po.

STRATEGJIA DIGJITALE

BKSh-së
Në mbështetje të rekomandimeve të Këshillit të Europës, të nismave të qeverisë për ndërtimin e një shoqërie digjitale, si edhe nga

potencialiteti i digjitalizimit, mundësi akcesi në vlerat e rralla të trashëgimisë kombëtare, - BK ka filluar të hedhë hapat e saj drejt projekteve, që mundësojnë integrimin e saj në botën digjitale botërore.

• Projektet e konvertimit retrospektiv
• Projekti i digjitalizimit të informacionit (dorëshkrime, antikuarë etj.)

PROJEKTET E KONVERTIMIT RETROSPEKTIV

• Projekti i konvertimit retrospektiv të koleksioneve të fondit albano-balkanologji(1989-1994) filloi në 2002 dhe përfundojnë 2006 (8.000 rekorde);
• Projekti i konvertimit retrospektiv të LibritShqip (1555-1995) ka nisur në 2005 (4.500 regjistrime).

PROJEKTI I DIGJITALIZIMIT TË INFORMACIONIT

Projekti i digjitalizimit të informacionit (skedave) të koleksioneve të rralla ka nisur në vitin 2007 (numërohen 1000 rekorde).

PROJEKTE TË REJA

Zhvillimi i bazës së dhënave: integrimi i regjistrimeve të skedave të digjitalizuara të vlerave të rralla në OPAC.



PROJEKTE TË REJA

- Digjitalizimi i periodikut: revista "ALBANIA";
- Digjitalizimi i vlerave të rralla PROJEKTE TË REJA;
- Digjitalizimi i periodikut: revista "ALBANIA";
- Digjitalizimi i vlerave të rralla.

BIBLIOTEKA DIGJITALE

Një mundësi, që tanimë po bëhet realitet edhe për trashëgiminë kulturore shqiptare.

CENL-ja & BKSh-ja

- Anëtare e CENL-së që prej 1997, BK ka bashkëpunuar dhe është përfshirë në projekte europiane nisma të mbështetura edhe nga Komisioni Europian;
- Projekti i parë: GABRIEL (GAteway and BRIdge to Europe's National Libraries);
- Projekti i fundmë TEL (The European Librarys).

Ç'është CENL-ja

- Është Konferenca e Bibliotekave Kombëtare Europiane, vendet e të cilave janë anëtarësuar në Këshillin e Europës;
- Mblidhet çdo vit;
- Aktualisht në të bëjnë pjesë 47 biblioteka kombëtare, përfshirë edhe Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë.

Misioni i CENL-së

- Të forcojë dhe rrisë rolin e bibliotekave kombëtare në Europë;
- Të krijojë e mbështesë bashkëpunimin maksimal ndërmjet rrjetit të bibliotekave kombëtare të Europës në epokën digjitale;
- Të ofrojë dhe lehtësojë qasjen e vijueshme në koleksionet e bibliotekave kombëtare të Europës në gjuhët më të përdorurura europiane;
- Të stimulojë shërbime të reja.

Projekti GABRIEL

GABRIEL-i ka qenë shërbimi zyrtar i Internetit bibliotekave kombëtare europiane,të përfaqësuara në Konferencën e Bibliotekave Kombëtare të Europës për vitet 1997-2004, ku përfshihej edhe BK.

Nisma më e fundit e CENL-së:

Krijimi i portalit të bibliotekave kombëtare të Europës:

The European Library (TEL)

http://www.theuropeanlibrary.org

The European Library (TEL)

TEL-i Është vijimi i projektit GABRIEL. BK është partnere në këtë nismë të re europiane. Projekti TEL ofron informacion të larmishëm, ku vend të veçantë zënë ekspozitat on line.



The European Library (TEL)
Në ekspozitën online të thesareve të trashëgimisë kulturore të bibliotekave kombëtare europiane BK (që prej krijimit të portalit në vitin 2005),është paraqitur me veprën e Barletit për Skënderbeun.

The European Library (TEL)
Portali aktualisht mundëson akces:
- në burime të kombinuara -digjitale dhe jodigjitale (libra, harta, dorëshkrime, foto etj.) të 32 bibliotekave kombëtare europiane, që prej vitit 2005;
- në 20 gjuhë;
- në 150 milion njësi bibliotekare (koleksionet e bibliotekave kombëtare të Europës).

PROJEKTI EUROPIAN FUMAGABA
Nisma më e fundit europiane, ku është përfshirë edhe Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë.

AKRONIMI
- The National Library of Former YugoslavRepublic of Macedonia
- The National Library of Ukraine
- The National Library of Moldova
- The National Library of Albania
- The National Library of Georgia
- The National Library of Armenia
- The National Library of Bosnia & Herzegovina
- The National Library of Azerbaijan

The European Library (TEL)
Projekti FUMAGABA është pjesë e projektit të madh europian The European Library (TEL), iniciuar nga CENL-ja.

Synon zgjerimin e akcesit në trashëgiminë e shkruar dhe shtyp-shkruar të bibliotekave kombëtare të Europës.
Projekti mbështetet nga Agjencia Zviceriane për Zhvillim.
Periudha
1 janar 2008 -1 korrik 2009

FINANCIMI
Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim do të përballojë shpenzimet përgatitore dhe shpenzimet e anëtarësimit për 3 vjet pas përfundimit të projektit (20092012).

OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

FUMAGABA
- Të mundësojë kërkimin nëpërmjet portalit të TEL-it edhe të koleksionet bibliotekare të 8 bibliotekave kombëtare -përfshirë së fundmi në projekt;
- Të mundësojë kërkimin në portal edhe në gjuhë shqipe.

PORTALI FLET SHQIP PORTALI FLET SHQIP



DEKLARATA E BASHKIMIT EUROPIAN
E ardhmja është digjitale.
Në hartimin e strategjive digjitale kombëtare sfidat janë të mëdha.
"Digjitalizimi është një hap i parë thelbësor për krijimin e përmbajtjes digjitale që do të mbështesë një Europë gjithë digjitale. Ai është një veprimtari e rëndësishme në ruajtjen e trashëgimisë kulturore kolektive të Europës, që siguron akces për qytetarët në këtë trashëgimi për të zgjeruar arsimin, turizmin dhe për të zhvilluar industritë me përmbajtje elektronike".

DOMOSDOSHMËRIA E NJË STRATEGJIE KOMBËTARE PËR BIBLIOTEKAT PUBLIKE NË EPOKËN DIGJITALE

Ramazan Vozga*

Ka ardhur koha tashmë për zhvillimin e strategjisë, politikave dhe ndërmarrjen e veprimeve në fushën e bibliotekave publike. Hartimi i një strategjie të qartë, brenda kuadrit ligjor të miratuar, është një domosdoshmëri për zhvillimin e mëtejshëm të rrjetit të tyre. Kjo strategji duhet të synojë hapjen e horizonteve të reja për politika zhvillimi në nivel kombëtar, me qëllim që këto biblioteka të funksionojnë sipas standardeve ndërkombëtare.

Siç do të shihet më poshtë, kjo nismë do të duhej të parashikonte një tërësi masash për arritjen e qëllimit të dëshiruar. Vizioni i ri për bibliotekat publike kërkon domosdoshmërish shfrytëzimin e të

* Ramazan Vozga - Qendra e Trajnimit Bibliotekar, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë. Kjo kumtesë është prezantuar më 15 prill 2008 në Bibliotekën Ndërkomunale të Prizrenit, në sesionin me temën: "Bibliotekat digjitale".

gjitha kapaciteteve të vendit, në nivel qendror dhe lokal, në mbështetje të zhvillimit të tyre. Kjo është arsyeja që duhet të synohet, mes të tjerash, angazhimi i forcave politike, kulturore dhe ekonomike në shkallë vendi për të siguruar mbështetjen e tyre maksimale në këtë fushë. Një strategji kombëtare për zhvillimin e këtyre institucioneve të rëndësishme do të përfaqësonte, në të njëjtën kohë, një mundësi domethënëse për integrimin e tyre në rrjedhat europiane.

Shqipëria ka bërë dhe po bën reforma të rëndësishme demokratike për t'iu ribashkuar komunitetit ndërkombëtar pas dekadash të tëra vetëizolimi. Edhe në fushën e bibliotekave, izolimi prej zhvillimeve të bibliotekonomisë dhe nga pjesa tjetër e botës pati sjellë pasoja serioze në nivelin e sotëm të njohurive dhe të aftësive menaxhuese të stafit aktual. Bibliotekonomia në përgjithësi dhe problemi i rritjes dhe përmirësimit të shërbimeve dhe informacionit në veçanti, si një nga detyrat kryesore të rrjetit kombëtar të bibliotekave, hasin në një numër të konsiderueshëm vështirësish. Aktualisht bibliotekat tona publike duhet të kalojnë përmes pengesash të ndryshme për përmbushjen e detyrave të tyre.

Për të kapërcyer këto vështirësi dhe pengesa është i domosdoshëm hartimi i një strategjie të re kombëtare. Kjo strategji është një domosdoshmëri në qoftë se duam të përgatisim një pozicion nisës të saktë që do të favorizonte ndryshime të suksesshme në të ardhmen. Duhet të jetë e qartë se një politikë e saktë dhe një legjislacion i përshtatshëm janë tepër të rëndësishëm për përmirësimin e gjendjes në këtë fushë. Por fatkeqësisht deri më tash bibliotekat tona kanë punuar pa një kuadër politik të qartë mbështetës. Nuk ekziston asnjë program konkret në kontekstin e një politike nacionale për nxitjen e zhvillimeve në këtë sektor.

Siç u tha më sipër, tashmë është pranuar rëndësia e një politike të përshtatshme dhe e një kuadri organizativ. Formulimi i tyre, natyrisht, është kompetencë e dikasterit të kulturës dhe duhet të

realizohet duke mbajtur mirë parasysh politikat kulturore kombëtare të qeverisë. Nga ana tjetër, lipset një konsultim dhe bashkëpunim me specialistët e fushës. Pra, në rend të ditës tashmë është hartimi i një strategjie të re kombëtare për zhvillimin e bibliotekave publike dhe përcaktimi i sfidave që duhen përballuar në mënyrë që ato të gjejnë vendin e tyre në epokën digjitale. Kjo strategji e re do të synonte kështu përshtatjen e tyre ndryshimeve të sotme sociale, profesionale dhe teknologjike. Fillimisht do të duhej të përcaktoheshin objektivat dhe qëllimet e kësaj strategjie, të parashikoheshin shërbimet e reja që ato do të ofrojnë, ndryshimet e domosdoshme në punën e tyre - me fjalë të tjera, do të duhej të krijohej një vizion i ri për të ardhmen e tyre. Një studim specialistësh do të duhej të gjente rrugët e sakta për arritjen e këtyre ndryshimeve duke analizuar së pari kërkesat, pengesat dhe mundësitë.

Pra lipset një strategji vizionare dhe rekomandime me vlerë pranë Ministrisë së Kulturës për aksione konkrete në mbështetje të modernizimit të bibliotekave.

Për realizimin e kësaj detyre duhen aktivizuar specialistë nga më të mirët e bibliotekave tona, duke krijuar kështu një lob që do të mbështeste zhvillimin e rrjetit kombëtar të bibliotekave publike. Duhen bërë përpjekje, gjithashtu, që të sigurohet edhe përkrahja e një lobi ndërkombëtar në vende dhe organizma të ndryshme europiane dhe më gjerë.

Objektiv kryesor i strategjisë në këtë fushë duhet të jetë përdorimi i i librit dhe materialeve të tjera bibliotekare prej të gjitha shtresave të shoqërisë shqiptare, duke mbajtur parasysh kategoritë e ndryshme sociale dhe kulturore të lexuesve. Është e kuptueshme që për të realizuar këtë objektiv të rëndësishëm është i nevojshëm formulimi i një kuadri ligjor të përshtatshëm si dhe krijimi i një rrjeti kombëtar efektiv bibliotekash publike në të gjithë vendin.

Për të ndërtuar këtë strategji kombëtare dhe për të përcaktuar

objektivat e saj, fillimisht është e domosdoshme të diagnostifikohet gjendja aktuale e bibliotekave. Ky diagnostifikim mund të përfshinte:
- mekanizmin ekzistues të zhvillimit të tyre
- rrjetin ekzistues
- shërbimet që u ofrohen përdoruesve
- promovimin e leximit
- komunitetin e bibliotekarëve etj.

Të dhënat e këtij diagnostifikimi do të ndihmonin për përcaktimin qartë të vështirësive, barrierave dhe pengesave. Dihet që diagnoza në vetvete nuk është sinonim i strategjisë: ajo është vetëm një prelud ose fazë përgatitore.

I rëndësishëm është përcaktimi i problemeve kryesore që preokupojnë sot bibliotekat publike. Në këtë drejtim mendojmë se pengesat më kryesore për zhvillimin e tyre mund të konsiderohen:
- mungesa e një strategjie
- mungesa e një kuadri ligjor të përshtatshëm
- një mbështetje politike e dobët
- imazhi ose statusi i tyre social i zbehtë
- mjetet e pakta financiare
- mungesat në formimin dhe trajnimin e stafit të tyre
- dobësitë menaxheriale
- ndërtesat e papërshtatshme dhe hapësirat e ngushta
- promovimi dhe marrëdhëniet me publikun
- mungesa e një sistemi të automatizuar të shërbimeve dhe të informacionit bibliotekar
- konservatorizmi
- etj.

Bibliotekat kanë për detyrë grumbullimin, ruajtjen dhe sigurimin e shfrytëzimit të të gjitha burimeve të dijes. Ato luajnë një rol të rëndësishëm si institucione demokratike që mundësojnë aksesin në pasurinë kulturore të shkruar. Bibliotekat gjithashtu e konsiderojnë veten qendra kulturore, ndaj shpesh organizojnë veprimtari të kësaj natyre. Niveli, veprimtaria dhe kapaciteti i tyre ndryshojnë që nga koleksionet e vogla të librave me shërbim të kufizuar deri te Biblioteka Kombëtare. Të gjitha ato u shërbejnë përdoruesve sipas mënyrave dhe mundësive të tyre. Bibliotekat publike p.sh. u vijnë në ndihmë të gjitha llojeve të arsimimit dhe edukimit në komunitetin ku veprojnë, sigurojnë shfrytëzim të vlerave kulturore dhe të informacionit të publikuar. Ato mbështesin kështu kulturën, identitetin dhe jetën sociale të komunitetit të cilit i shërbejnë, si pjesë e kulturës, identitetit dhe jetës sociale kombëtare.

Konkretisht bibliotekat tona ofrojnë:
- akses në trashëgiminë kombëtare dhe atë të huaj
- huazim të materialeve bibliotekare (kryesisht të shtypura)
- veprimtari kulturore
- mjedise për mbledhje të ndryshme
- ekspozita dhe veprimtari të tjera

Është bërë zakon që në Shqipëri bibliotekat të konsiderohen thesar kombëtar dhe funksioni i tyre është mbështetja e kulturës si bazë e identitetit të kombit. Por me ndryshimin e sistemit politik dhe zhvillimet e Shoqërisë së Informacionit, bibliotekat tona qenë të detyruara të përballojnë sfidat eventuale dhe të rikonsiderojnë rolin e tyre në jetën e shoqërisë shqiptare. Kjo është një prej arsyeve më kryesore që na detyron ta shikojmë me përparësi formulimin e një strategjie të qartë zhvillimi për to.

Disa prej objektivave kryesore të strategjisë së re për bibliotekat publike mund të ishin:
- Ripërcaktimi i rolit, detyrave dhe funksioneve të tyre
- Përgatitja e akteve nënligjore, vendimeve, rregulloreve, udhëzimeve të ndryshme që rregullojnë funksionimin e tyre
- Përshtatja ndryshimeve sociale dhe teknologjike
- Shndërrimi i bibliotekave nga institucione “burokratike” në

institucione ku mësohet ose shndërrimi nga qendra thjeshtë kulturore në institucione të të mësuarit gjatë gjithë jetës
- Të ofruarit jo vetëm të librave dhe materialeve të tjera të shtypura, por të të gjitha llojeve të informacionit si dhe të aksesit në mediat e reja
- Ose: rinovimi i shërbimeve tradicionale dhe zhvillimi i shërbimeve të reja për përdoruesit
- Kalimi nga faza e punës manuale drejt automatizimit të funksionimit të bibliotekave me qëllim që ato të mos jenë thjeshtë magazina librash me një shërbim të kufizuar informacioni, por burime të gjalla informacioni për përdoruesit e tyre
- Vendosja e një bashkëpunimi në shkallë kombëtare përmes krijimit të rrjetit kombëtar të bibliotekave
- Integrimi i tyre në sistemin kombëtar të informacionit
- Kapërcimi i vështirësive kryesore:

  • *ekonomike*
  • *teknike*
  • *profesionale*
  • *sociale*

- Formulimi i një koncepti të ri për bibliotekat:
- *akses i lirë dhe i pakufizuar*
- *shmangia e çdo lloj ideologjie*
- *lidhja e ngushtë e tyre me institucionet e tjera të kujtesës si muzetë dhe arkivat*
- *përfshirja në jetën kulturore*
- *sigurimi i aksesit në çdo lloj informacioni etj.*
- Marrja në konsideratë e kërkesave të veçanta të zonave rurale
- Përshtatja e bibliotekarëve kërkesave të epokës digjitale, krijimi i modeleve të reja të sjelljes dhe fitimi i njohurive të tilla si ato që kanë të bëjnë me:

kompjuterët
futjen e shërbimeve të reja
planifikimin strategjik dhe riorganizimin
promovimin dhe marketingun
punën me projekte
gjetjen e burimeve të reja financiare etj.

- Aftësimi profesional; theksi kryesor në përgatitjen e bibliotekarëve të mbetet ruajtja dhe shërbimi i trashëgimisë së shkruar, por ajo duhet të përfshijë edhe njohjen me teknologjinë informatike dhe aplikimin e saj në biblioteka
- Automatizimi i bibliotekave, pra futja e teknologjisë informatike në to, t'u shërbejë rritjes dhe përmirësimit të funksioneve të tyre: *qarkullimi, pasurimi, katalogizimi,verifikimi i fondeve etj.*
- Kalimi drejt bibliotekave multimediale, akses në mediat e reja (CD-ROM etj.), fundi i bibliotekave të modës së vjetër
- Domosdoshmëria e një konceptimi modern nga ana e politikanëve, ligjvënësve, vendimmarrësve dhe financuesve për vlerat e bibliotekave ; ndryshimi i qëndrimit të tyre
- Vënia në pah e përfitimeve ekonomike, kulturore dhe edukative që vijnë prej bibliotekave
- Krijimi i marrëdhënieve me komunitetitn botëror të bibliotekarëve për të siguruar asistencë teknike me synim integrimin e bibliotekave tona në zhvillimet bashkëkohore si edhe përgatitja e projekteve të përbashkëta me kolegë të huaj.

BIBLIOTEKA DIGJITALE NË SHËRBIM TË KUJTESËS KOMBËTARE

Besim Kokollari &
Ramush Zeka*

- Bibliotekat digjitale nuk lindën rastësisht, ato u krijuan si nevojë e grumbullimit,organizimit, shërbimit dhe ruajtjes së materialeve, apo thënë më mire informacionit, të krijuar apo konvertuar në formë digjitale.
- Mbase në fillim ato kanë evoluar edhe si nevojë e përshkrimit, fotografimit apo skanimit të materialeve të vjetra dhe vendosjes së tyre në kompjuter, për t'i ruajtur nga prekja fizike nga përdoruesit, e të cilët kanë pasur nevojë për atë material.

- Krijimi i bibliotekave digjitale
- Përkufizimi i bibliotekave digjitale

* Besim Kokollari dhe Ramush Zeka, janë udhëheqë të Sistemit të automatizuar bibliotekar Aleph 500 në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Ky abstrakt është përmbledhje e një artikulli më të gjerë të prezantuar gjatë manifestimit Java e Bibliotekës në Kosovë, më 15 prill 2008 në Bibliotekën Ndërkomunale të Prizrenit në sesionin me temën: "Bibliotekat Digjitale".

- Natyra e dokumenteve digjitale
- Mjetet dhe teknologjitë e zbatuara
- Shembuj të bibliotekave digjitale

- Digjitalizimi, ashtu si krijimi dhe zhvillimi i mikroformatit, është bërë për ta ruajtur kopjen origjinale të paprekshme, e natyrisht, edhe për ta vënë në dispozicion të një mase më e gjerë lexuesish.
- Më pas me zhvillimin e internetit, pasi bibliotekat e para digjitale u krijuan para ardhjes së internetit, ato materiale u bënë të mundshme të shfrytëzohen nga çdo kompjuterë që kishte lidhje interneti.

- *"Bibliotekat digjitale janë organizata të cilat ofrojnë burime, kanë personel të specializuar për të përzgjedhur, organizuar, ofruar qasje në burime intelektuale, interpretuar, shpërndarë, ruajtur integritetin, dhe sigurojnë jetëgjatësinë e koleksioneve digjitale kështu që ato të janë të gatshme për t'u përdor nga një bashkësi apo bashkësi të ndryshme".*

Federatës së Bibliotekave Digjitale (1998)

- *"Një organizim virtual i mundshëm që mbledh në shkallë të gjerë, menaxhon dhe ruan në afat të gjatë përmbajtjen e pasur digjitale, dhe u ofron përdoruesve të saj funksione të veçanta për atë përmbajtje, të një cilësie të matshme sipas politikave të përcaktuara".*

Leonardo Candela (2007)

- Natyra e dokumenteve digjitale është më komplekse. Tashmë kemi dhjeta e dhjeta formate e gjuhë programuese të ndryshme në të cilat prezantohen dokumentet digjitale. Sa për të përmendur disa, dokumente të tilla janë ato, si: Word, Excel, PDF, HTML, XML, XHTML, RDF, pastaj GIF, JPEG, TIFF, MPEG4, MP3, CD, DVD, e shumë të tjera.
- Sa duken komplekse këto formate në të cilat ruhen informacionet, ato kanë një element universal të përbashkët – mënyrën se si kompjuteri e ruan dhe e kupton informacionin e këtyre dhe formateve të tjera (Harter, 1997). Çdo karakter në dokumentet digjitale, qoftë shkronjë, numër, fotografi, zë, etj., në teknologjinë e kompjuterit, ruhet si bit (Buckland, 1998).

- Sistemet kompjuterike, makinat kërkuese, programet e automatizuara bibliotekare kanë përparuar mjaft në mënyrën e nxjerrjes së informacionit nga dokumentet digjitale të shkruara në formë teksti.
- Ata i indeksojnë fjalët të veçuara, kuptojnë renditjen e fjalëve në fjali duke vënë rregulla alogortimike, pastaj i kuptojnë edhe parashtesat e prapashtesat, siç është rasti me përdorimin e shenjës së yllit *, në fund të një fjale që gjeneron të gjitha variantet e asaj fjale.

- Në krijimin dhe zhvillimin e bibliotekave digjitale bënë pjesë një numër i gjerë kommponetesh teknologjike, prej harduerit e deri te softuerët e ndryshëm komercial e jokomercial.
- Programet kompjuterike falas (anglisht O*pen Source Software*), janë në dispozicion për instalim të secilit individ apo institucion, i cili dëshiron të shfrytëzojë atë teknologji.
- Ato janë të hapura për ndryshime, modifikime, konfigurime të mëtutjeshme, etj.

- UNESCO ofron një listë të gjerë të programeve të ndryshme falas në internet, duke përfshirë nga programet për biblioteka digjitale, programe vetëm për katalogim e deri të programe të plota për sisteme të automatizuara bibliotekare.

- Më poshtë kemi shkoqitur vetë disa prej programeve të cilat janë mjaft të popullarizuara dhe në përdorim të gjerë nga bashkësia e bibliotekave digjitale.
    - Greenstone
    - DSpace
    - Fedora
- **Greenstone** - i zhvilluar në Zelandë të re nga Universiteti Waikato në bashkëpunim me UNESCO-në dhe organizatën joqeveritare Human Info NGO, ofron një mjetë të fuqishëm në organizimin, menaxhimin dhe gjetjen e informacioneve në biblioteka digjitale.
- Greenstone zë hapësirë të vogël instaluese në kompjuter, instalohet në të gjitha versionet e Windows, Unix/Linux, dhe Mac OS-X.
- Karakteristikë tjetër është se mbështet pamje shumë-gjuhësore të programit, pastaj mbështet të gjitha formatet e metadatave, si dhe ofron fleksibilitet të modifikimit e konfigurimit të mëtutjeshëm.



- **DSpace** - i zhvilluar nga Bibliotekat MIT (Massachussets Institute of Technology) dhe Hewlet Packard Labs, është një program tjetër falas në internet.



- Program ky mjaft i përhapur nëpër institucione të ndryshme për ruajtjen e koleksioneve digjitale. Mund të instalohet në UNIX ose Linux.
- **Fedora –** një program tjetër falas, platforma e së cilës mbështetet në katër shërbime: shërbimit të depoziturës, shërbimit të ruajtjes, shërbimit semantik, dhe shërbimit evolues.
- Ajo ofron veçori nga më të ndryshmet si konvertimi i formateve, integrim me makinat kërkuese, pastaj kontroll në qasje, versione të ndryshme të gjeneruara nga përmbajtja, pamje dinamike të objekteve digjitale, etj.

- Ofron mundësi të ndryshme të konfigurimit, modifikimit dhe evoluimit për të qenë vazhdimisht program i kohës.

- **Kujtesa Amerikane** *(American Memory),* është një nga burimet më madhështore të Bibliotekës së Kongresit si dhe materialeve të pafundme të historisë amerikane, me më shumë se 9 milion njësi që dokumentojnë historinë, dhe kulturën e SHBA.
- **Biblioteka Digjitale e Botës** *(World Digital Library),* e që është ende në fazën e projektit, por që gëzon një mbështetje të madhe nga UNESCO.
- Një bibliotekë tjetër digjitale, por e zhvilluar nga Biblioteka Kombëtare e Francës është *Gallica*, e cila ofron 90000 vëllime të skanuara, 80000 pamje (faqja e internetit e Gallica), 1200 vëllime në tekst të plotë, si dhe 500 dokumente audio.

- Bibliotekat digjitale u zhvilluan si rezultat i evoluimit të formateve në të cilat prezantohet tradita, kultura, historia, trashëgimia intelektuale, kreativiteti I njerëzimit. Ato, me një fjalë, vazhdojnë traditën e bibliotekave tradicionale të cilat merreshin me mbledhjen, organizimin, shërbimin dhe ruajtjen e materialeve të prekshme, por tash të një mediumi të ri.
- Nga vet përkufizimi i tyre, bibliotekat digjitale mund të thuhet që kanë po të njëjtin vizion, mision e aspirata që kishin e vazhdojnë të kenë bibliotekat tradicionale, përveç tjerash, ruajtjes së dokumenteve digjitale për brezat e ardhshëm – ruajtjen e kujtesës së një qytetërimi.

- Para nesh ndodhën qindra e mijëra informacione që presin intervenimin tonë për ruajtjen e tyre, si rasti me dorëshkrimet, librat e vjetër, gazetat, e revistat të cilat kanë filluar të zbehen, shkrimi në to të venitet e pothuaj në disa raste edhe është bërë i palexueshëm, për shkak të cilësisë së ulët të letrës në të cilin janë shtypur e nganjëherë edhe për shkak të kushteve jo të mira për ruajtjen e tyre.

- Një prej formave të ruajtjes së tyre, por jo e vetme natyrisht, mund të jetë digjitalizimi i tyre dhe eventualisht vënia e tyre në një bibliotekë digjitale e cila do të ruaj me fanatizëm kujtesën shpeshherë të harruar të këtij kombi, si dhe me krenari do ta prezantojë atë te audienca mbarëbotërore e interesuar për të.

- Kjo formë e re, ky koncept i ri i paraqitjes së kulturës së një kombi dhe ruajtjes së saj paraqet evoluimin më të ri të bibliotekave pa e ndërprerë veprimtarinë tradicionale të bibliotekave por duke e shtyrë atë më përpara, duke e avancuar atë më shumë, dhe duke i vënë bibliotekat në vazhdimësi në ballë të mbledhjes, organizimit, ruajtje së *Kujtesës* së njerëzimit pa marrë parasysh formën të cilën e merr, e në rastin tonë ruajtjes së *Kujtesës shqiptare.*

Literatura:

- Brown, Mary E. (2005). History and definition of digital libraries: http://www.southernct.edu/~brownm/dl_history.html;
- Buckland, Michael. (1998). What is a "digjital dokument": http://people.ischool.berkeley.edu/~buckland/digdoc.html;
- Candela, Leonardo et al. (2007). Setting the foundations of digjital libraries: the DELOS manifesto. *D-Lib Magazine, 13* (3/4): http://www.dlib.org/dlib/march07/castelli/03castelli.html;
- Digital Library Federation. (1998). A working definition of digital library [1998]. Digital Library Information: http://diglib.org/about/dldefinition.htm;

- DSpace. (s.a.). FAQ: http://www.dspace.org/index.php?option=com_content&task=blogcategory&id=40&Itemid=88;
- Fedora Commons. (s.a.). About Fedora Commons: http://www.fedora-commons.org/index.php;
- Gallica, bibliothèque numérique de la Bibliothèque nationale de France. (s.a.). Gallica: http://gallica.bnf.fr/;
- Hart, Michael. (1992). Gutenberg:The History and Philosophy of Project Gutenberg: http://www.gutenberg.org/wiki/Gutenberg:The_History_and_Philosophy_of_Project_Gutenberg_by_Michael_Hart;
- Harter, Stephen P. (1997). Scholarly communication and the digital library: problems and issues. *Journal of Digital Information*, *1* (1): http://journals.tdl.org/jodi;
- Lesk, Michael. (2005). Understanding digital libraries (2nd ed.). Amesterdam: Elsevier. National Library of Finland. (2007). Doria: https://oa.doria.fi/;
- New Zealand Digital Library Project. (2007). Greenstone digital library software: (Factsheet): http://www.greenstone.org/factsheet;
- Oxford Digital Library: http://www2.odl.ox.ac.uk/gsdl/cgi-bin/library/;
- Savage, Anne. (c1998-2006). The alphabet in binary code. Tekmom: http://www.tekmom.com/buzzwords/binaryalphabet.html;
- The University of Chicago Library/Digital Activities & Collections: http://chopin.lib.uchicago.edu/;
- UNESCO. (2007). News: the Director-General attends the presentation of a vision for a World Digital Library: http://portal.unesco.org/ci/en/ev.php-URL_ID=25547&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html;

- Wikipedia. (2007). Digital library: http://en.wikipedia.org/wiki/Digital_library;
- Wikipedia. (2007). Library: http://en.wikipedia.org/wiki/Library;
- World Digital Library. (2007). World Digital Library: www.worlddigitallibrary.org.

BIBLIOTEKA NË SHEK. XXI, MES TRADICIONALES, AUTOMATIZIMIT DHE DIGJITALES

MA. Gjon Berisha*

Deri kohëve të fundit teknikat e veprimtarisë bibliotekare (blerjet, përpunimi, katalogimi dhe qarkullimi) si dhe materialet bibliotekare (tekstet kryesore) njësojë janë bazuar në letër dhe skeda/kartela: të emëruar si "*Bibliotekë Letre*"
Para dy dekadash, teknikat e veprimtarive bibliotekare janë bazuar mbi teknologjinë kompjuterike, kurse materialet bibliotekare edhe më tutje janë mbetur përherë në letër dhe në ato të ngjashme: të emëruara si "*Biblioteka të Automatizuara*".
Që nga viti 1992 dukshëm është rritur numri dhe llojllojshmëria e materialeve të përafërt me formatin elektronik: statistika qeveritare, tekste mesjetare, fotografi satelitore, fotografi dokumentare (lëndëve) muzeale dhe shumë gjëra të tjera interesante. Gjasat se materiali bibliotekar dhe veprimtaria bibliotekare do të kalojë në

* Gjon Berisha - punon në Departamentin e Katalogimit në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Kjo kumtesë është prezantuar më 15 prill 2008 në Bibliotekën Ndërkomunale të Prizrenit, në sesionin me temën: "Bibliotekat digjitale", gjatë Javës së Bibliotekës në Kosovë.

formën elektronike, tregon domosdoshmërinë e zbatimit të mëtutjeshëm të formës elektronike në shërbimet bibliotekare „*Biblioteka Elektronike*“

Nocioni biblioteka elektronike është i rëndësishëm për shkak se shumë materiale bibliotekare do të kenë qasje në formë të rregullt më të lexueshme; për përdoruesin qasja në një material të tillë do të jetë më e nevojshme dhe kjo qasje gjithsesi duhet t'i mundësohet. Mund të spekulohet mbi krijimin e baraspeshës në mes materialit letër, ose nëse dëshirojmë, mbi parashikimet për bibliotekën jo letrare (letër), por këto janë çështje jo shumë të rëndësishme në krahasim me nevojën themelore për sigurimin e qasjes në materiale elektronike. Bibliotekat e sotshme janë ose po bëhen biblioteka të automatizuara me nevojën e domosdoshme që domosdo bile pjesërisht të zhvillohen në biblioteka elektronike. Duke marrë parasysh se ka gjasa të mëdha që dokumentet në letër (si dhe dokumentet të tjera jo-elektronike si p.sh. filmi) nuk do të zhduken, mund të presim që bibliotekat elektronike dhe ato të automatizuara më tutje të bashkëjetojnë. Më saktësisht, mund të shpresojmë, por edhe duhet të planifikojmë që çdo shërbim bibliotekar të jetë ndërlidhje e bibliotekës elektronike dhe asaj të automatizuar.

Lëvizja kah veprimtaria elektronike, e sidomos paraqitja e veprimtarisë bibliotekare në formë elektronike, tregon ndryshimet radikale në mjetet e shërbimeve bibliotekare. Materialet bibliotekare në formë elektronike ndryshojnë shumë nga materialet tradicionale. Sidomos ndryshon nga letra dhe mikrofilmi, nga se qasja elektronike mund të sigurohet ashtu që ajo:

- mund të shfrytëzohet nga largësia;
- njëkohësisht mund ta shfrytëzojnë shumë persona, dhe;
- mund të shfrytëzohet në shumë mënyra.

Lloji i bibliotekës	Shërbimet bibliotekare	Materiali bibliotekar
Bibliotekat me letër	Letër	Letër
Bibliotekat e automatizuara	Kompjuter	Letër
Bibliotekat elektronike	Kompjuter	Medium elektronik

Biblioteka tradicionale

Biblioteka tradicionale (me letër) ka probleme me obligimin e vet që të krijojë bazën për nivelimin (barazimin) e parashikimeve mbi bibliotekat e automatizuara dhe elektronike dhe për përcaktimin sa më të saktë të mundësive të ndryshme të bibliotekave letër, elektronike dhe të automatizuara.

Shërbimet bibliotekare të cilat ne i njohim më së miri bazohen në teknologjinë e letrës, kartelave dhe skedave, të cilat ekzistojnë në katalogë, janë vetëm një formë e veprimtarisë tradicionale. Veprimtaria bibliotekare çdo ditë e më tepër po automatizohet dhe bibliotekat tradicionale (letër) po zhvillohen në atë drejtim që ne i quajmë biblioteka të automatizuara. Biblioteka tradicionale në një afat më të gjatë është treguar frytdhënëse dhe jetëgjate. Mirëpo problemet e saj janë real dhe të rëndësishëm. Zakonisht njerëzit brengosen për të metat dhe përparësitë e përdorimit të kompjuterit, por pak kujdes i kushtohet përparësisë dhe të metave të shfrytëzimit të letrës. Nëse dëshirojmë që të nxjerrim një vlerësimin të barabartë të dy llojeve të tjera të bibliotekave të automatizuara dhe elektronike, të metat kryesore të bibliotekës tradicionale duhet njohur dhe përshkruar hollësisht.

1. Saktësisht letra është një medium i kufizuar. Kopja e letrës dhe përdoruesi duhet të jenë brenda të njëjtit vend dhe të në të njëjtën kohë. Dokumenti në letër dhe përdoruesi duhet të jenë në të njëjtin vend për ta lexuar atë që aspiron. Kjo duket si banale, por ky është fakti që dominon në funksionin dhe konstruksionin e një dokumenti në bibliotekën tradicionale.

2. Një dokument i vetëm në letër, që është brenda, mund të përdoret në të njëjtën kohë vetëm nga një person dhe gjithnjë dokumenti është në rrezik nga përdoruesi tjetër (paraprak).
3. Një kopje e dokumentit në letër mund të shumëzohet me fotokopje dhe rishtypet apo me ndonjë formë tjetër të reproduktimit modern, por kjo kërkon kufizime për shumëzimin nga kopja e origjinalit.
4. Dokumenti tradicional është gati jo-fleksibil. Shpeshherë dokumentet në letër mund të kenë shtojca dhe formate jostandarde.
5. Koleksionet nga letra për kah vëllimi janë të mëdha dhe vazhdimisht krijojnë probleme në lidhje me vendosjen e tyre (kërkojnë hapësira të mëdha në biblioteka dhe arkiva).

• *Karakteri lokal i dokumentit*

Dokumenti në letër thuhet se ka karakter lokal, për faktin se një kopje p.sh., në Bibliotekën e Vatikanit është pak mundshme që të përdoret nga një përdorues potencial në Hon Kong.

• *Hapësira për dokumentet në letër*

Madhësia e letrës në bibliotekë është një problem madhor. Cila prej bibliotekave ka mundësi të vazhdueshme për dokumentet letër. Vetëm në SHBA gjatë viteve 1967-1974 janë ndërtuar vazhdimisht biblioteka, por nuk i kanë mbuluar nevojat për vëllimet e mëdha të materialeve në letër. P.sh., problemi kryesor në 10 Qendrat e Universitetit në Kaliforni ka qenë se për çdo vit, për vendosjen e koleksioneve, iu është nevojitur 19.3 kilometra hapësirë.

• *Fleksibiliteti i dokumenteve në letër*

Problemi i dokumenteve në letër është jo-fleksibiliteti i tyre. Mikrofilmi mund të jetë një ndihmesë e vogël në këto rrethana. Mikrofilmi mund të shumëzohet, por prodhimi i tekstit ka disa komplikime.

• *Katalogu i letrës në biblioteka*

Format standarde të katalogut në letër, kanë filluar të përdorën gati që nga shek. XIX në formë të librit. Kohë pas kohe janë botuar botime të vogla për përdorues për t'u njohur me fondet e bibliotekave. Në mënyrë të ngjashme, me formën e katalogut të fortë, çdo formë e qasjes ka kërkuar: një skedë për autor, një për titull, një tjetër për emërtimet lëndore-subjektin, etj.

• *Ndarja e katalogut nga teksti*

Në bibliotekën tradicionale katalogu fizikisht është i ndarë nga teksti. Libri mund të jetë në rafte, por të mos ketë të dhëna në katalog. Që të gjenden të dhënat s'do të thotë që të gjendet edhe libri, kjo është vetëm shënim i vendit zyrtar në rafte ku libri mundet, por nuk do të thotë që edhe të jetë gjithmonë aty (kjo ndodh shpesh edhe në bibliotekat tona).

• *Ndarja e përdoruesit nga katalogu dhe dokumentet*

Për bibliotekën tradicionale grumbullimi i përmbledhjeve vendore të zgjedhura mirë është i domosdoshëm, por jo edhe kusht i përshtatshëm për fushëveprim. Lokale/ vendore donë të thotë "*afër përdoruesit*", por siç thekson Robert T. Jordan, në praktikë ekziston diferenca e madhe ndërmjet „*afër përdoruesit*", dhe „*atje ku janë përdoruesit*". Analizat e shfrytëzimit të informatave burimore(duke përfshirë bibliotekat) gjithnjë e më shumë na udhëzojnë se në praktikë përdorimi varet shumë nga qasja fizike: përdorimi pëson rënie të madhe edhe atëherë kur largësitë janë të vogla, si p.sh. në rastin e bibliotekave akademike (universitare) kur koleksionet gjendet në një pjesën tjetër, kurse përdoruesi në pjesën tjetër.

Tek bibliotekat tradicionale, përdoruesi duhet ta vizitojë bibliotekën që të shikojë në katalog dhe në mungesë të shërbimit për huazim apo informacion, ai personalisht duhet ta kërkojë librin ose dokumentin nëse ai gjendet diku.

• *Orari i punës*

Të rralla janë ato biblioteka që punojnë 24 orë në ditë dhe shtatë ditë në javë.

Më tepër bibliotekat tradicionale janë të mbyllura, gjithashtu nuk kanë qasje as në shërbime pjesën më të madhe të kohës. Së kënde-

jmi edhe përdorimi i materialeve tradicionale në çdo kohë është i pamundur.

Biblioteka e automatizuar

Shprehjen bibliotekë e automatizuar e shfrytëzojmë që ta përshkruajmë bibliotekën në të cilën koleksionet bibliotekare para se gjithash janë në letër, kurse procedurat për përdorim janë të automatizuara. Bibliotekat punojnë me shumë të dhëna: nuk ekzistojnë vetëm të dhënat për tituj të ndryshëm, por në kuadër të veprimtarisë bibliotekare janë të nevojshme të dhënat për çdo ekzemplar të ndonjë titulli. Sistemi i qarkullimit di saktësisht të dallojë në mënyrë precize: sa kopje, sa vëllime, sa botime, sa tituj janë huazuar dhe kur duhet të kthehet. Të dhënat mbi furnizimin duhet të tregojnë se sa ekzemplarë të veprës së caktuar saktësisht janë porositur, tek cila librari dhe në sa ekzemplarë. Të dhënat mbi revistat përmbajnë edhe më shumë detaje në disa ekzemplarë të një numri, treguesve, lidhjes dhe llogarive në mënyrë që të sigurohet që çdo vit në mënyrë të plotë dhe të rregullt të pranohen dhe paguhen. Për çdo ekzemplar të caktuar duhet të ekzistojnë të dhënat bibliotekare.

Në përgjithësi preferohet që bibliotekat të automatizojnë ruajtjen e të dhënave për tri arsye:

1. Bën menaxhimin e saktë të të dhënave. Këto punë sipas natyrës janë monotone, rutinore dhe mekanike, kurse mund të automatizohen edhe pse nganjëherë të dhënat apo shkrimet janë të ndërlikuara dhe të radhitura në mënyrë të komplikuar.
2. Automatizimi sigurisht do të përmirësojë ekonomizimin e veprimtarisë duke shtuar saktësinë, duke zvogëluar shkallën e rritjes së shpenzimeve për punët e kërkuara dhe rritjen e kapacitetit të dëshiruar. Sigurisht se disa punë do të kryhen në mënyrë më cilësore se sa ato të kryheshin me dorë, siç është furnizimi i rregullt me numrat e periodikut që nuk kanë arritur ose kryerja e punëve të cilat në praktikë nuk mund të kryhen me kartoteka nga letra.
3. Automatizimi mundëson qasje të decentralizuar të shënimeve. Bibliotekari në degën e ndonjë biblioteke mund ta përcaktojë statusin e porosisë pa pasur nevojë të ketë në dispozicion shënime të dyfishta, të shkojë deri te seksioni për porositje (kërkesë për material) ose të lusë personelin tjetër që ta ndërpresë punën për të marrë informacione. Përdoruesi mund të vërtetojë se a është i huazuar libri dhe të mos ketë nevojë të shkojë në bibliotekë.

Automatizimi i bibliotekës është mjet i fuqishëm për hapjen e saj me publikun. Ai u siguron përdoruesve hyrje të shpejtë dhe pa kufizim në informacionin e depozituar jo vetëm brenda një biblioteke, por edhe jashtë saj. Bibliotekat që do t'i automatizojnë katalogët e tyre bazohen në standardet përkatëse.

Standardet më të rëndësishme ndahen në tri grupe:

- Në grupin e parë bëjnë pjesë standardet që duhen siguruar dhe të vihen në përdorim, si:
  1. ISBD – Standardet Ndërkombëtare të përshkrimit Bibliografik
  2. AACR2 – Rregullat Anglo-Amerikane të Katalogimit
  3. Formatet MARC (UNIMARC, MARC 21, etj)
- Në grupin e dytë bëjnë pjesë një seri standardesh ISO (Internacional Standard Organization), si:
  1. ISO:2108 (për ISBN)
  2. ISO:3279 (për ISSN)
  3. ISO:3166 (kodet e emrave të vendeve), etj.
- Në grupin e tretë bëjnë pjesë standarde të domosdoshme për personelin teknik si:
  1. Protokolli Z39.50 ("kërko dhe gjej")
  2. Protokolli Z39.2 (amerikan)

a. Pa protokollin "*Kërko dhe gjej*" përdoruesi mund të lidhet në katalogët e ndryshëm on-line por duhet ta dijë se si përdoret secili sistem.

b. Me protokollin "*Kërko dhe gjej*" (Z39:50) e vetmja gjë që përdoruesi duhet ta dijë është si ta shfrytëzojë katalogun lokal dhe si t'i urdhërojë që ta zgjerojë kërkimin në sistemet e tjera.

Problemet e bibliotekës së automatizuar

Automatizimi i bibliotekës nuk i ndryshon disa probleme të bibliotekës tradicionale të cekura më lartë. Duke pasur parasysh se koleksionet e bibliotekës edhe më tutje janë në letër, atëherë natyra lokale e materialit, hapësira për koleksione në letër, papërshtatshmëria e dokumenteve letër, ndarja e dokumenteve nga përdoruesit, kufizimi i kohës së qasjes për shkak të orarit të punës (edhe pse këto kufizime më nuk kanë të bëjnë me katalogët) dhe rivaliteti për disa ekzemplarë, janë disa nga problemet me të cilat janë të pranishme edhe në bibliotekën e automatizuar njësoj sikurse edhe në bibliotekën tradicionale.

Biblioteka e automatizuar paraqet përmirësim të dukshëm, por vetëm për disa probleme, dhe përveç katalogut on-line njëkohësisht u shërben edhe atyre që ofrojnë shërbime, por jo edhe atyre që i shfrytëzojnë.

Bibliotekat elektronike

Me të hyrë në shekullin XXI, ne po hyjmë në "*epokën digjitale*". Sipas literaturës relevante, shuma e informacioneve të prodhuara në botë, për secilin vit, është përafërsisht 1-2 eksabajt. Këto informacione ekzistojnë kryesisht në formë të fotografive, të zërave dhe të dhënave të koduara. Si rezultat, bibliotekat që tradicionalisht janë marrë me ruajtjen dhe shpërndarjen e materialeve me tekste,

të tilla si libra dhe botime serike, janë duke u ballafaquar me nevojën për reformim.

Nocionin "*bibliotekë elektronike*" e përdorim për të përshkruar bibliotekën në të cilën dokumentet janë ushqyer në formën elektronike, e jo në letër dhe formate të tjera. Megjithatë, duhet të kemi parasysh se në shumicën e rasteve mund të përpunohen ekzemplarë të shtypur të dokumenteve elektronike ose pjesë të tyre në mënyrë që lexuesi t'i shfrytëzojë më lehtë.

Nocioni "*digjital*" përdoret për tekstin në të cilin çdo shkronjë, çdo numër apo shenjat e tjera janë posaçërisht të koduar me disa shifra të caktuara, kurse nocioni i"*digjitalizuar*" paraqet fotografinë e cila përbëhet prej shumë shifrave.

Fotografia e digjitalizuar e faqes së tekstit mund të ekzistojë, por në këtë rast asnjë shenjë në vete nuk është e koduar si e tillë. Nëse shenjat janë të formuara mirë dhe në mënyrë të drejtë, me ndihmën e teknikës për njohjen e formularëve në fotografinë digjitale, disa shenja mund të identifikohen nga fotografia e faqes digjitale, pra mund të fitojmë versionin digjital të shenjave në tekst. Shënimi digjital i tekstit është më ekonomik dhe kryesisht më i favorshëm se fotografia digjitale.

Frederick Kligour zhvillimin e botimeve elektronike e ka përshkruar në katër nivele:

1. përgatitja e tekstit në formën rendore (rreshtore) të lexueshme për zhvillimin ekzemplarëve në letër, me ç'rast versioni i lexuar hidhet;

2. botimi i ekzemplarëve në letër dhe ekzemplarëve në formën rendore (rreshtore) dhe të lexueshme;

3. botimi vetëm i ekzemplarëve në formën rendore (rreshtore) dhe të lexueshme, dhe;

4. botimi i informacioneve në formën rendore (rreshtore) në bazën enciklopedike të të dhënave.

Dokumentet elektronike

Cilësia e dokumenteve elektronike për shumëçka ndryshon nga cilësia e dokumenteve në letër:

1. Dokumentet elektronike nuk janë të lokalizuara. Me ndihmën e kompjuterit dokumenti mund të përdoret nga kudo, e që përdoruesi mos ta dijë se ku është i vendosur dokumenti gjeografikisht.
2. Të njëjtën bazë të të dhënave apo shënimet elektronike njëkohësisht mund të përdorin disa përdorues.
3. Dokumentet elektronike shumëzohen me lehtësi.
4. Dokumentet e krijuara në formatin elektronik janë shumë fleksibile, lehtë përmirësohen, zhvendosen, ndërrohen dhe kombinohen me dokumente të tjera.
5. Përmbledhjet e dokumenteve të krijuara në format elektronik sot janë të një intensiteti më të vogël sesa versioni letër. Ekziston tendenca që këto të rriten.

Nga çdonjëra nga këto pesë cilësi të rëndësishme, dokumentet elektronike dukshëm dallojnë nga dokumentet në letër.

Dokumentet elektronike, pa marrë parasysh se a ekzistojnë edhe në formatin letër apo jo, kanë përparësi në rastet vijuese:

1) Kur dokumentet kanë vlerë kaluese. P.sh. nuk është mirë të varemi në materialin e shtypur, i cila ka përmbajtje të ndryshueshme, siç janë orari i fluturimeve, çmimet dhe kursi i valutave.
2) Kur është e nevojshme që dokumenti të përpunohet (p.sh., redaktimi etj.). Askush nuk ka dëshirë që t'i përshkruajë nga fillimi (apo ndoshta t'i përshkruajë gabimisht) të dhënat e shtypura të nevojshme nëse veç eksitojnë të dhënat në formën elektronike.
3) Kur i kërkojmë titujt, fjalët e caktuara ose shprehjet në ndonjë dokument më të madh. Të mundohemi ta gjejmë vendin (p.sh. në pjesën e shtypur prej shumë fletëve apo në disa numra të revistave), ku ceket ndonjë gjë apo person, është shumë e lodhshme dhe rezultatet janë plotë gabime. Askush më nuk do të dëshironte që „*me dorë*“ ta përpunojë një dokument: Hapi i parë në përpunimin e dokumentit sot është te përpunimi i ekzemplarit elektronik të tekstit.
4) Për shfrytëzimin sipërfaqësor të materialit në largësi. Për leximin detal të dokumentit, i cili nuk ka qasje lokale më së miri do të ishte që ekzemplari të sigurohet me huazimin ndërbibliotekar. Mirëpo, nëse shfrytëzimi është sipërfaqësor - vërtetimi i disa të dhënave apo shfletimi sipërfaqësor, duhet shikuar se a ia vlen leximi i kujdesshëm i tërë materialit. Në këto raste është e dëshirueshme qasja e shpejtë kompjuterike në dokumentin elektronik.
5) Kur kërkohet komunikimi i shpejtë, sidomos në grupe njerëzish, të cilët nuk mund të tubohen në të njëjtën kohë në të njëjtin vend. Shfrytëzimi i postës elektronike ka përparësi të dukshme në krahasim me shfrytëzimin e postës së thjeshtë dhe në raste të caktuara edhe në krahasim me përdorimin e telefonit.

Integrimi i dokumenteve elektronike

Sipas M. Gorman-it, organizimi i dokumenteve elektronike dhe faqeve të ndryshme në internet, ndahet në pesë lloje:

1. Materialet me interes të vogël;
2. Burimet me prejardhje nga materialet e shtypura;
3. Faqet komercial;
4. Revistat elektronike;
5. Arkivat e digjitalizuara. (Gjerë me tani arkivat që sipas definicionit janë "unike", kanë pasur qasje vetëm studiuesit, të cilët kanë pasur kohë dhe mjete për të udhëtuar për në arkiva, tani kanë filluar që të mos kenë më këtë epitet)

Bashkëjetesa e dokumenteve në *letër* dhe atyre *elektronike*

Edhe pse mund të pritet rritje drastike e numrit të dokumenteve elektronike, ndikimi i tyre (në raport me dokumentet letër) dukshëm do të ndryshojë nga rasti në rast. Më tutje, siç edhe është theksuar, në disa raste janë më të dëshirueshme dokumentet letër. Nuk do të jenë gjithherë në qasje dokumentet në formën elektronike. Dokumentet në letër sigurisht se nuk do të zhdukën, dhe kjo as nuk do të dëshirohet. Kështu që debati mbi bibliotekën me koleksione nga letra sigurisht që pak do të ishte i dobishëm. Vetëm disa çështje themelore janë të rëndësishme për planifikim:

- Dokumentet elektronike gjithnjë e më shumë po bëhen më të rëndësishme, andaj edhe duhet zhvilluar planin që me anë të bibliotekës elektronike, të cilën më së miri do të ishte ta shikojmë si plotësim dhe mundësi për qasje në ato dokumente. Kjo formë shtesë e shërbimit bibliotekar nuk është vetëm e dëshiruar, por zbatimi i saj në botë është i paevitueshëm.
- Shërbimet bibliotekare prej tash duhet të sigurojnë qasjen në dokumentet në letër dhe ato elektronike, sipas nevojave të përdoruesve. Me fjalë të tjera, planifikimi bibliotekar duhet bazuar në supozimin se të gjitha bibliotekat do të zhvillohen në një kombinim të bibliotekave të automatizuara dhe elektronike.
- Dallimi në mes bibliotekës elektronike dhe të automatizuar është në teknologjinë e dokumenteve, e jo qasjen bibliografike. Shënimet bibliografike duhet të përmbajnë të dhëna mbi cilësinë fizike të çdo materiali bibliotekar(p.sh. letër, mikrofilm, formate elektronike, optike), por më e mira sigurisht do të ishte qasja unike bibliografike për të gjitha dokumentet. Sistemi bibliografik dhe procedurat e shfrytëzuara në veprimtarinë e bibliotekës së automatizuar nuk ka nevojë të ndryshojnë shumë para kalimit nga biblioteka e automatizuar në atë elektronike.



- Qëndrimi mbi bibliotekën elektronike si plotësim i bibliotekës së automatizuar duhet ndryshuar në dy mënyra.

a. E para, me këtë nuk duhet kuptuar vetëm deponimin monetar shtesë. Edhe pse mund të ofrohet një argument i fortë se financimi i bibliotekës së automatizuar është i pamjaftueshëm (siç ka ndodhur më herët me bibliotekën letër) prapëseprapë pritet që prioritetet e shërbimit bibliotekar shpejt do të arrijnë deri te ndarja e mjeteve të përgjithshme bibliotekare nga biblioteka e automatizuar në kombinimin e bibliotekës së automatizuar dhe asaj elektronike. Në këtë kuptim biblioteka elektronike mund të jetë plotësuese duke marrë parasysh se kjo është një formë e re e shërbimit.

b. E dyta, nën ndikimin e disa rrethanave të caktuara do të bëhet e pranueshme që dokumentet në letër të zëvendësohen me ato elektronike dhe që biblioteka e automatizuar të transferohet në atë elektronike. Kur përdoruesi i katalogut on-line elektronik të bëhet i zakonshëm dhe i sigurt, në një moment do të jetë e logjikshme që të lihet katalogu me skeda me shpenzimet e veta të larta të mirëmbajtjes. Kur versionet bibliografike on-line mund të kërkohen lehtë, parapagimi në bibliografitë e shtypura, përnjëherë, sidomos në disa raste nuk do të ketë kuptim. Gjithashtu, është logjike të presim se, kur do të jetë e mundur zgjedhja, për shfrytëzim do të jetë më e dëshirueshme shfrytëzimi i dokumenteve elektronike se sa ato letër, edhe nëse versioni në letër është më i përafërt për qasje.

Gjatë shqyrtimit - diskutimit mbi bibliotekat elektronike, botëkuptimi thelbësor është se është i nevojshëm sigurimi i qasjes në dokumentet elektronike. Si do të zhvillohet marrëdhënia në mes dokumenteve letër dhe atyre elektronike, është një çështje interesante por jo aq e rëndësishme.

Literatura:

Michael Buckland. *Redesigning Library Services*: A Manifesto. URL: http://sunsite.berkeley.edu/Literature/Library/Redesigning/html.html;
Michael Gorman. Postojana knjiznica: tehnologija i potraga za ravnoteznom / prevela Irena Kranjec. Zagreb: Hrvatsko knjiznicarsko drustvo, 2006.- (Posebna izdanja Hrvatskoga knjiznicarskog drustva; knj.11);
Michael Gorman. *The endurin library: technology, tradition, and the quest for balance*. Chicago: American library association, 2003;
Katalogimi Eletronik: *AACR2 dhe metadatat për botimet serike dhe monografike* / Sheila S. Intner, Sally C. Tseng, Mary Lynette Larsgaard. Prishtinë: biblioteka kombëtare dhe Universitare e Kosovës, 2005;
Jennifer Rowley. *The electronic Library: fourth edititon of Computers for libraries*. London: Library Association Publishing, 1998;
Wilson, Thomas C. *Sistemski knjiznicar: oblikovanje uloga, definiranje vjestina*/ preve Mladen Masar. Zagreb: Hrvatsko knjiznicarsko drustvo, 2006.- (Posebna izdanja Hrvatskoga knjiznicarskog drustva; knj.10);

BIBLIOTEKAT DIGJITALE - PROCESI I DIGJITALIZIMIT NË BKUK

Lavdie Rrahmani*

Sot ekzistojnë më shumë se 250 000 biblioteka në gjithë botën. Misioni i bibliotekave është të ruajnë koleksionet e tyre ashtu që në të njëjtën kohë ato të jenë në dispozicion për përdoruesit aktual si dhe të siguruara për gjeneratat e ardhshme.
Me fillimin e përdorimit të kompjuterëve u zhvillua koncepti i krijimit të bazave të mëdha të të dhënave bibliografike, koncept që më vonë u shoqërua me sistemet e qasjes online të cilat janë pjesë e një biblioteke bashkëkohore. Më tutje interneti bëri të mundur fillimin e krijimit të informacionit digjital në të cilin mund të ketë qasje çdonjëri nga çdo vend i botës. Termat : Bibliotekë Virtuale, Bibliotekë Elektronike dhe së fundmi termi Bibliotekë Digjitale janë përdorur në vazhdimësi duke i lëshuar vendin njëra - tjetrës

* Lavdie Rrahmani është shefe e Departamentit për Zhvillimin e Koleksioneve Bibliotekare në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Kjo kumtesë është prezantuar më 15 prill 2008 në Bibliotekën Ndërkomunale të Prizrenit, në sesionin me temën: "Bibliotekat digjitale", gjatë Javës së Bibliotekës në Kosovë.

për të përshkruar këtë koncept të gjerë. Termi Bibliotekë Digjitale tani është më aktuali për faktin se gjithnjë e më tepër po përdoret në konferenca të ndryshme me karakter ndërkombëtar dhe në literaturën botërore.

Me zhvillimin e teknologjive të reja informative, praktikat bibliotekare janë modifikuar në mënyrë radikale: dita - ditës po shtohet numri i bibliotekave të cilat po i bashkëngjiten fushatës për digjitalizimin e punës së tyre.

Një prej qëllimeve kryesore të bibliotekës digjitale është krijimi i koleksioneve digjitale. Praktikat e deritashme kanë treguar tri metoda të suksesshme të krijimit të Bibliotekave Digjitale:

- digjitalizimi - konvertimi i formave të ndryshme të materialit bibliotekar nga koleksionet ekzistuese në forma digjitale;
- pasurimi i bibliotekës me forma digjitale origjinale të botuara nga botues të ndryshëm si: libra elektronik dhe revista elektronike;
- qasja në materiale të gjera të ueb faqeve, koleksione të bibliotekave të tjera ose shërbimeve të botuesve.

Digjitalizimi i koleksioneve bibliotekare, në fakt, nuk do të thotë vetëm ruajtje dhe sigurim i materialit nga dëmtimet e ndryshme apo rezistim ndaj kohës dhe numrit të përdorimeve, por gjithashtu e bën atë sa më të përshtatshëm për t'u përdorur nga publiku i gjerë, nëpërmes formave të ndryshme të komunikimit se dhe materialin e rrallë dhe të vlefshëm e bën të akceptueshëm për publikun e gjerë. Bibliotekat digjitale grumbullojnë informacionin që bibliotekat dhe arkivat vazhdimisht e përshtatin për kompjuterët me prezantimin e tyre në formë digjitale.

Zhvillimi i programeve digjitalizuese ofron mundësi për bibliotekat në përfshirjen e qytetarëve që nuk mund të kenë përdorur më përpara shërbimet e tyre dhe veçanërisht për të inkurajuar qytetarët të bëhen pjesëmarrës aktivë dhe të aftë në shfrytëzimin e mundësive të botës së punës në rrjet në të cilën ne jetojmë sot.

Qëllimet dhe përparësitë e Bibliotekave Digjitale

Për më shumë se një dekadë, pothuajse çdo fjalë e shkruar ka qenë e përgatitur në kompjuter. Paradoksalisht deri ditët e fundit më së shumti leximi është bërë nga letra. Tani shpërndarja digjitale e postës elektronike dhe e ueb faqeve ka sjell ndryshime të mëdha në fushën e shkëmbimit të informacionit. Neve na pëlqejnë informatat digjitale sepse janë në dispozicion të secilit por njëkohësish janë të mbrojtura dhe të ruajtura mirë për t'i rezistuar kohës.

Me avancimin e teknologjisë digjitale, një pjesë e madhe e punës krijuese sot është në dispozicion vetëm në formë elektronike. Prandaj, si rezultat, bibliotekat po përballen me sfida të ndryshme. P.sh. botuesit e revistave elektronike licencojnë përmbajtjen e botimeve të tyre për bibliotekat, por bibliotekat nuk mund t'i zotërojnë dhe nuk kanë të drejtë të përvetësojnë përmbajtjen digjitale për ta ruajtur.

Qëllimi kryesor i ndërtimit të bibliotekave digjitale është besimi se ato do të sigurojnë shpërndarje më të mirë të informacionit se sa që ishte e menduar në të kaluarën.

Derisa bibliotekat tradicionale janë të limituara në hapësirat e depove, bibliotekat digjitale kanë potencial të ruajnë më shumë informacion në mënyrë më të lehtë sepse informacioni digjital kërkon hapësirë më të vogël fizike dhe njëkohësisht këtë Informacion ta shpërndajnë shumë shpejt në gjithë botën.

Gjithashtu edhe kostoja e krijimit të Bibliotekave digjitale është më e ulët se sa ajo e bibliotekave tradicionale. Bibliotekat tradicionale duhet të shpenzojnë shuma të mëdha parash për pagesat e stafit, mirë mbajtjen e librit dhe të gjithë materialit bibliotekar që nga skedarët manual e tutje. Bibliotekat digjitale nuk kanë nevojë për këto pagesa.

Zakonisht, bibliotekat krijojnë hapësirat e tyre për nevojat e përdoruesve duke u bazuar në disa kritere, si: numri i banorëve, numri i frekuentuesve të periudhave paraprake, numri i studen-

tëve etj, mirëpo është fakt se kohët e fundit përdorimi i kompjuterit dhe lidhja në rrjetin e internetit kanë shënuar rritje të madhe. Kjo ka ndikuar që numri i përdoruesve dhe vizituesve fizikë të bibliotekës të zvogëlohet. Prandaj ky numër nuk është më matje e mirë dhe e saktë se sa persona janë duke përdorur shërbimet e bibliotekës.
Tashmë po bëhet gjithnjë e më qartë që në të ardhmen do të jetë e nevojshme të planifikohen dhe menaxhohen shërbime publike të informacionit në rrjet së paku në baza kombëtare. Koleksionet digjitale të bibliotekave do të jenë jashtëzakonisht të rëndësishme si një kontribut për pasurinë digjitale kombëtare.

Procesi i digjitalizimit në BKUK

Kur BKUK filloi iniciativat e para të automatizimit, një pjesë e stafit të saj si dhe njerëz të tjerë nga jashtë i panë me dyshim investimet e burimeve financiare dhe humane në çfarë ata perceptuan një aventurë të rrezikshme. Fatmirësisht, në këto iniciativa, BKUK pati përkrahje nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare.
Tani, këto iniciativa, të vlerësuara më parë si jo shumë të sigurta, gjithnjë e më tepër po arsyetohen, posaçërisht me tërheqjen e fondeve të shumta nga organizata dhe institucione të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore. Tani suksesi është i dukshëm dhe të gjithë mendojnë dhe besojnë se ne po shkojmë në drejtimin e duhur.
BKUK së bashku me gjithë komunitetin bibliotekar në Kosovë dhe me ndihmën e institucioneve financiare dhe të miqve të Bibliotekës po shtrin rrjetin e programit ALEF 500 në të gjitha bibliotekat rajonale të vendit dhe në të gjitha degët e bibliotekat e fakulteteve të Universitetit të Prishtinës. Kështu po krijon konceptin e Bibliotekës së të Nesërmes dhe Katalogun Unik të Kosovës.

BKUK po zhvillon programin nacional të digjitalizimit, qëllimi kryesor i të cilit është konvertimi i koleksioneve me rëndësi historike e kulturore në forma digjitale duke i bërë ato të përshtatshme për rrjetin e internetit. Këto koleksione do ta përbëjnë projektin "Kujtesa e Kosovës" (projekt ky i filluar më herët por për mungesë burimesh financiare veç tani në vitin 2008 ka filluar së realizuari).
Në momentet e zhvillimeve në të cilat ndodhet tani BKUK do të jetë shumë me rëndësi roli dhe angazhimi i saj për :
mbledhjen dhe ruajtjen e burimeve të rëndësishme kombëtare të informacionit;
bashkëpunimin me institucionet tjera për të siguruar burimet më të rëndësishme dhe krijimin e kushteve të nevojshme për ruajtjen e tyre;
bashkëpunimin me institucionet e tjera për të siguruar se po krijojmë një infrastrukturë efektive nacionale për regjistrimin, gjetjen, vënien në dispozicion për qasje të lirë dhe shpërndarjen e burimeve të rëndësishme të informacionit.

Përfundim

Digjitalizimi i materialeve me vlerë kulturore e historike që posedojnë bibliotekat dhe institucionet e tjera relevante në Kosovë si arkivat, muzetë, galeritë nga format ekzistuese tradicionale në radhë të parë materialeve dhe dokumenteve të selektuara posaçërisht për koleksionet e *Kujtesës së Kosovës* është një proces që kërkon mbështetje dhe përkujdesje të vazhdueshme profesionale e financiare nga institucionet më të larta të vendit.
Tani po bëhet gjithnjë e më qartë që në të ardhmen do të jetë e nevojshme dhe e domosdoshme të planifikohen dhe menaxhohen shërbime publike të informacionit në rrjet në fillim në baza kombëtare. Planifikimi i këtyre shërbimeve ka ecur përpara në shumë vende të botës.

Besojmë se nëse procesi do të ecë me ritmin që ka filluar, shumë shpejt trashëgimia digjitale e Kosovës do t'u bashkëngjitet projekteve të mëdha botërore siç është projekti i *Bibliotekës Digjitale të Botës.*
Një prej gjërave që unë mendoj se duhet të qartësohet më mirë për gjithë komunitetin shqiptar të bibliotekave është se koleksionet digjitale dhe bibliotekat digjitale nuk janë e njëjta gjë. Prandaj profesionistëve të kësaj fushe u mbetet që në të ardhmen të merren më shumë me çështje të këtij segmenti kaq të rëndësishëm në bibliotekarinë moderne. Ne kemi nevojë të kuptojmë dallimin në mes këtyre dyjave si dhe relacionet në mes koleksioneve digjitale dhe bibliotekave digjitale. Kjo do të na ndihmonte të qartësojmë qëllimet tona për krijimin e koleksioneve digjitale dhe gjithashtu do të na ndihmonte në definimin e kuptimit të Bibliotekave digjitale. Kështu do të kuptohej më mirë roli i koleksioneve digjitale dhe bibliotekave digjitale si dhe do të qartësoheshin disa nga qëllimet dhe misionet kryesore të tyre.

DIGITAL LIBRARIES

Karen Coyle*

Physical library Physical library
- Has a physical location
- Library serviceslimited by what library owns
- Serves mainly userswho come to the library

Digital libraries can be distributed



Distribute copies:
LOCKSS - Lots of Copies
Keeps Stuff Safe

* Karen Coyle është konsultante për Bibliotekat Digjitale në Universitetin e Kalifornisë në SHBA. Ky abstrakt është përmbledhje e një artikulli më të gjerë të prezantuar më 15 prill 2008, në Prizren, në manifestimin Java e Bibliotekës në Kosovë.

Multiple copies can bestored in different locations with little added cost
Institutions can share materials over the

Multi-mediaMulti-media

All digital data types canbe included, available under a single interfacewith a single search

Many digital librariesgathering news video, sound recordings, Web sites, and other media that today are already digital in nature

Digital materials present challenges



- Digital materials present challenges
- Require software and hardware for use
- Cataloging or metadata isessential (digital items cannot be'discovered' on a shelf)
- Long term preservation is difficult

Metadata is EssentialMetadata is Essential

- Identifiers are essential for storage and retrieval

ark
Archival Resource Key
PURL
Persistent URL
Web-friendly identifiers

Full cataloging is expensive; minimum metadata is better than none at all

dc:title = Photograph of market, London
dc:date = circa 1920
dc:creator = unknown
dc:type = photograph

Dublin Core metadata
Digital files need preservation, too



Digital must be usable, now, and over time

Using digitized materials

- Scanned materials do not have structure (unless added at time of scanning) (egchapters, headings)
- Optical character recognition (OCR) works best with modern materials with no defects
- Reading software not well developed

Many different formats, software and hardware for reading digital books

"FlipBook"







Creating digital libraries; what you need

- Software (and smart technical staff)
- Hardware
- Internet connection
- Standards
- A community

Digital Library Software

- Storage and retrieval
- Sharing
- Digitization management
- Metadata creation

Digital Library Software

Much is Open Sourceand free.

Requires technical expertise.

Training is available.

Digital Library Standards

Standards create interoperability



A community

- Digital libraries work well on a large scale
- Share costs
- Share materials
- Share technology (this is why standards are important)

Digital libraries are possible with...
... some technology
... some brain power
... and an international community of libraries

working in the same direction

DIGITIZING ARCHIVES

Karen Coyle*

Planning
Planning before digitizing is the key to success

Step 1: Selection
- Value of the content (historical, current scholarship)
- Usability of digital version (e.g. search capabilities)
- Nature of the collection (can it be partially digitized?)

Potential users
- Faculty, researchers
- Schools
- Government and business
- Scholars abroad

* Karen Coyle është konsultante për Bibliotekat Digjitale në Universitetin e Kalifornisë në SHBA. Ky abstrakt është përmbledhje e një artikulli më të gjerë të prezantuar më 16 prill 2008, në Prishtinë, në manifestimin Java e Bibliotekës në Kosovë.

Potential uses
• Is there sufficient context for study?
• Will the files be usable?
Will the formats be ones scholars can work with?

Material types
• print and manuscripts (text, maps, etc.)
• photographs and artworks
• sound, video, film

Different material types have different challenges and costs

Portioning
• If a whole collection is very large, is there a portion that could represent it?

Retrieval capabilities
• Is there already sufficient metadata to assure retrieval?
• If no metadata exists, does the library have the skills to create it?
• What other types of retrieval are possible for this data type? (OCR and Keyword indexing)

Delivery capabilities
• Are there legal barriers to open access? (©)
• Are there technical barriers? (e.g. bandwidth)

Trade-offs
• Digitize more at a lower quality
• Digitize less but at a higher quality

Digitization context
• Rapidly deteriorating materials
• One-time funding

• Other digitization projects
• Possibilities for be cooperative effort
• 'There will always another day'



Finally....

Step 2. Digitization
Workflow

Workflow



Workflow





Digitization Workflow Software

Digitization Workflow Software
"Digitization Assets Factory" (DAF)
Bibliotheca Alexandrina
http://wiki.bibalex.org/DAFWiki/



Workflow



documenting original

- decide goals for metadata (identification, retrieval...)
- determine level of cataloging
- use identifiers when possible
- create metadata (cataloging) as early as possible in the process so it can be used during digitization steps

Documenting digital copy

- Document technical aspects
- Use standards where possible

Very complex!

Some standards

- Digital Image Collection Standards,

University of California, Digital Library
http://www.cdlib.org/inside/diglib/guidelines/bpgimages/
"These guidelines primarily define approaches for creating digital master files to facilitate affordable reprocessing."

Some standards

- PREMIS, Preservation Metadata,

Library of Congress
http://www.loc.gov/standards/premis/
"A data dictionary and supporting XML schemas for core preservation metadata needed to support the long-term preservation of digital materials."

Some standards

- METS, Metadata Encoding and

Transmission, Library of Congress
http://www.loc.gov/standards/mets/
"...a standard for encoding descriptive, administrative, and structural metadata regarding objects within a digital library..."



KËNDI AMERIKAN PËR QASJE NË INFORMATA DHE PROGRAME TË NDRYSHME ZHVILLIMI

Alex Laskaris*

Këndet amerikane janë partneritete ndërmjet ambasadave amerikane dhe institucioneve vendore nëpër tërë botën. Ato janë të modeluara sipas bibliotekave publike tipike amerikane dhe mundësojnë qasjen në informatat më aktuale dhe të besueshme për Shtetet e Bashkuara nëpërmjet koleksioneve të librave, revistave dhe internetit. Ato po ashtu paraqesin një hapësirë të mrekullueshme për zhvillimin e programeve të tjera; në këtë kënd amerikan, për shembull, dy mësuese të gjuhës angleze të sponzoruara nga Ambasada e SHBA-ve mbajnë orë të rregullta të gjuhës angleze për grupe multi-etnike të nxënësve të shkollave të mesme dhe të studentëve universitarë. Po ashtu, vullnetarë nga radhët e studentëve universitarë drejtojnë seanca të komunikimit në gjuhën angleze për grupe studentësh, orën e përrallave për

*1 Fjala e Alex Laskaris, zëvendës-shef i Misionit të Ambasadës së SHBA-ve në Prishtinë, me rastin e hapjes së Këndit të ri Amerikan më 14 prill 2008, gjatë aktivitetet Java e Bibliotekës në Kosovë. Titulli i këtij punimi është i redaksisë.

fëmijë dhe mbajnë seanca të rregullta për shikim të filmave në grupe. Ne po ashtu planifikojmë që ta shfrytëzojmë këtë kënd amerikan për mbajtjen e programeve kulturore në të ardhmen.

Ne jemi krenarë që Kosova ka tri kënde amerikane: një në Prizren, një në veri të Mitrovicës dhe një këtu në Prishtinë. Përveç krijimit të këtyre këndeve amerikane, Ambasada e SHBA-ve vazhdimisht i ka ndihmuar bibliotekat e Kosovës nëpërmjet programeve trajnuese mbi shkencat e bibliotekarisë dhe duke sponzoruar vizita të ekspertëve që vijnë për të referuar për çështjet kryesore të bibliotekarisë gjatë Javës së Bibliotekës në Kosovë.
Ne kemi shpenzuar $60,000 gjatë muajve të fundit për ta bërë këtë hapësirë të këndshme si dhe produktive për ata që vijnë t'i shfrytëzojnë resurset e saj. Ky kënd amerikan është tanimë plotësisht i integruar në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare. Resurset e Këndit janë të regjistruara në katalogun qendror të Bibliotekës dhe koordinatorja e Këndit, Arta Buzhala, është bibliotekare e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.
Resurset e këndit përbëjnë një pjesë të veçantë të koleksionit të Bibliotekës, koleksion me të cilin shpresojmë se Biblioteka vërtet mund të jetë krenare.
Dhe tani, kam kënaqësinë t'i prezantoj zotit Bashota dhe Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare këtë pllakë dedikimi për Këndin Amerikan në Prishtinë, më datën 14 prill 2008.

BIBLIOTEKAT – TEMPUJT TË VLEFSHËM TË NJË KOMBI

Shefki Osmani*

Në vend të hyrjes

Bibliotekat më shekuj kanë kryer funksione jetike shumë të rëndësishme në ruajtjen dhe kultivimin e lidhjeve midis së kaluarës dhe së ardhmes, midis historisë dhe shoqërisë. Andaj çdo komb nëpër shekuj ka bërë përpjekje për ta ruajtur dhe pasuruar trashëgiminë kulturore dhe historike përmes bibliotekave, të cilat paraqesin ekzistencën e tij shpirtërore dhe historike.
Bibliotekat në të gjitha kohët, edhe atëherë kur kanë ndodhur përplasjet të shumta midis realitetit jetësor dhe atij shoqëror-kanë luajtur rol të madh në ngritjen dhe pajisjen e lexuesit me njohuri dhe mendime domethënëse për rrjedhat e shoqërisë e të qytetërimit njerëzor në veçanti.

* Shefki Osmani - drejtor i Bibliotekës Ndërkomunale "Fan Noli" në Gjilan. Kjo kumtesë është prezantuar më 17 prill 2008 në Bibliotekën Ndërkomunale të Gjilanit në sesionin me temën: "Bibliotekaria në Kosovë", gjatë Javës së Bibliotekës në Kosovë.

Përmes bibliotekave njerëzit kanë siguruar informacione të bollshme për rrjedhat e zhvillimit kulturor, mendor, shkencor dhe të traditës më të mirë të zhvilluar nëpër dekada e formacione të ndryshme shoqërore. Bibliotekat me misionin e tyre fisnik, janë shndërruar në kujtesë të pazëvendësueshme të së kaluarës, janë shndërruar në një vulë e kohës nëpër shekuj, dukë shërbyer si një udhërrëfyes për të ardhmen.

Roli i Bibliotekës Ndërkomunale "Fan S. Noli"

Biblioteka Ndërkomunale "Fan S. Noli" e Gjilanit, natyrisht se është brenda vijave të detyrave që mund t'i ketë një bibliotekë e mirëfilltë. Ajo me dekada, herë më shumë e herë më pak, luajti rolin e dobishëm në të mirë të lexuesit, duke ofruar materialin e bollshëm, për të thelluar dituri në rrugën e sigurt drejt një të ardhmeje të ndritur.
Roli i saj është edhe më i madh duke pasur parasysh pozitën e saj në këtë trekëndësh gjeografik në të cilin gravitojnë tash dhe gravituan në të kaluarën shqiptarët nga Kosova (Anamorava), nga Maqedonia (Kumanova me rrethinë) dhe nga Kosova Lindore (Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë).
Autori i këtyre rreshtave kishte pasur fatin e mirë dhe të ketë njëkohësisht përgjegjësinë, që të ishte drejtuesi i parë, pas Luftës së fundit, i këtij institucioni kulturor. E kishte fatin e mirë, sepse së bashku me punëtorët e vyer të Bibliotekës dhe me përkrahjen e Institucioneve vendore dhe donatorëve të shumtë, arriti brenda një kohe të shkurtër të kthente bibliotekën në një gjendje të mirë dhe funksionale, ndërsa e kishte fatin e keq, sepse e gjeti bibliotekën të rrënuar dhe të shkatërruar, madje disa prej punkteve të saj, të vendosura nëpër fshatra, edhe të djegura, siç kishte ndodhur më atë të Llashticës, ose më libra dhe inventar të vjedhur e të asgjësuar.
Shumë rrugë që lidhen me kulturën, arsimin, shkencën, traditën

dhe me jetën e popullit shqiptar në Kosovë, kanë të njëjtin fat me rrugën nëpër të cilën, sidomos gjatë viteve 1999-2008, ka kaluar biblioteka "Fan S. Noli", e Gjilanit. Biblioteka Ndërkomunale "Fan S. Noli" e Gjilanit, pa dyshim ka përballuar probleme jo aq të vogla, me të cilat është ndeshur në veprimtarinë e saj duke arritur suksese dhe rezultate që kanë afirmuar librin dhe kanë krijuar traditë për ta dashur e për ta respektuar bibliotekën, e cila objektivisht u ka hapur shtigje dhe ka afirmuar ide e forma të dobishme të dijes për lexuesit.
Jemi dëshmitarë se pjesa më e mirë e krijuesve, e lexuesve dhe e ekspertëve të fushave të ndryshme të dijes e të mendimit shkencor të kësaj ane - janë ngritur pak a shumë në sallat e kësaj biblioteke; aty kanë marrë mësimet themeltare dhe aty kanë thithur njohuritë për gjërat që atyre u kanë interesuar. Në njëfarë mënyre shumica e lexuesve të kësaj ane ishin nxënës të bibliotekës dhe me të drejtë mund të konkludojmë se Biblioteka ofronte një atmosferë të këndshme që përjetojnë lexuesit në të gjitha rrafshet.
Biblioteka "Fan S. Noli", gjatë gjithë ekzistimit të vet, ka qenë përherë mikpritëse e denjë e lexuesve të shumtë dhe përmes shtypit të përditshëm, revistave të shumta, botimeve te reja, paraqitjes së veprave nga të gjitha trojet shqiptare, organizimit të panaireve të librave dhe fondit të madh të librave të zhanreve dhe gjinive të ndryshme. Ajo ka ushqyer prirjet e tyre dhe u ka dhënë nxitje e kurajë, madje i ka edukuar përherë në formimin e shëndoshë ideoestetik dhe njerëzor. Lexuesit e ndryshëm, pikërisht në saje të leximit të vazhdueshëm të veprave në bibliotekën "Fan S. Noli" kanë arritur që gjithanshëm ta kuptojnë një pjesë të realitetit për botën dhe njerëzimin qoftë në librat artistike, qoftë në veprat shkencore.
Bashkëpunimi i ndërsjellë i Bibliotekës me bibliotekat simotra nga Kosova, sidomos me Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe me ato nga Shqipëria, Kroacia e vendet e tjera, trego-

jnë një nivel të lartë në drejtim të krijimit të urave të miqësive ndërmjet lexuesve. Prandaj, mbetet detyrë e vazhdueshme që udhëheqësit e bibliotekave dhe njerëzit që janë në ballë të institucioneve të kulturës, të arsimit, të shkencës që t'u kushtojnë rëndësi e hapësirë të duhur binjakëzimit të bibliotekave, sepse këto janë forma e mënyra të rëndësishme, të cilat afirmojnë librin dhe krijojnë bazë të shëndoshë në edukimin e shijeve të masave për të qenë më afër librit.

Në vend të përfundimit

Duke parë rolin e bibliotekave në përgjithësi dhe rolin e Bibliotekës Ndërkomunale "Fan S. Noli" të Gjilanit në veçanti, mund të theksojmë se bibliotekat janë institucione të ndjeshme dhe njëkohësisht shumë të rëndësishme për të kuptuar esencën që ka libri në zhvillimin dhe afirmimin e vlerave të nevojshme të kulturës dhe të dijes së njeriut.
Qëndrimi i drejtë i të gjithëve ndaj Bibliotekave në krijimin e një infrastrukture moderne dhe funksionale për zhvillim bashkëkohor të punës në biblioteka, formon dhe ngre fuqishëm vetëdijen tonë për rolin e librit dhe të kulturës kombëtare e botërore në përgjithësi. Padyshim, një hap shumë i mirë në avancimin e punës së Bibliotekave në Kosovë, është edhe Implementimi i Sistemit të Integruar Bibliotekar Aleph 500.
Prandaj, duke pasur parasysh këto që cekëm më lartë, me të drejtë mund të themi se bibliotekat, mbi të gjitha, janë tempuj shumë të vlefshëm në formimin e një identiteti të qëndrueshëm të një kombi.

BIBLIOTEKAT PËRBALLË SFIDAVE

(Me vështrim të veçantë në Kosovë)

Mr. Tahir Foniqi*

Hyrje

Historia e bibliotekave përbën njërën prej kaptinave më interesante kulturore të mbarë civilizimeve botërore. Tash dihet mirë për zanafillën e bibliotekave të para në botë, të njohura me emrin "Biblioteka-arkiva", të cilat iu përkasin civilizimeve sumere 4500-5000 vjet më parë. Ato janë gjetur në qytetet e Mesopotamisë: Kish, Ebla, Eridu, Lagosh, Ur, Nipur etj. Material i këtyre bibliotekave kanë qenë rrasat argjile të shkruara me shkrimin piktografik e kunjor.
Bibliotekat e para në Kosovë, si kulturë mesjetare, datojnë nga shekulli XIV dhe hasen në kisha, manastire, xhami, medrese, teqe

* Tahir Foniqi është shef i Departamentit të Bibliografisë në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Kjo kumtesë është prezantuar më 17 prill 2008 në Bibliotekën Ndërkomunale të Gjilanit në sesionin me temën: "Bibliotekaria në Kosovë", gjatë Javës së Bibliotekës në Kosovë.

etj. Deri më tash nuk janë gjetur fakte që vërtetojnë ekzistimin e bibliotekave në Kosovë përpara shekullit XIV, pa i parë këtu bibliotekat private.

Diçka për djegien e bibliotekave

Djegia apo shkatërrimi i bibliotekave është i hershëm edhe në trevat shqiptare. Jahja Drançolli njofton për djegien e Bibliotekës së Madhe të Durrësit pas sulmit të gotëve. Prej vitit 1878-1914, në trojet shqiptare, nga pushtuesit e ndryshëm, janë shkatërruar 8450 biblioteka private. Tash dihet mire edhe si ka përfunduar një pjesë e madhe e librave të bibliotekës së poetit Lasgush Poradeci: "Ti e di bibliotekën time. Ty të duken ndofta shumë këto libra që kam, po ti nuk e di se sa kam pasur. Dhe çfarë libra kam pasur! Ato s'gjenden më… Po, ç'u bënë do-më thuash. Ç'u bënë! Këtë e dimë unë dhe Nafija… Kur erdhi kjo kohë-që i thanë çlirim-doli një listë me emrat e librave të cilat duhet të hiqeshin nga bibliotekat private, d.m.th. të zhdukeshin. Po bashkë me to unë zhduka edhe shumë të tjera. Pse? Nga frika! Se të shkonte koka po të thoshte ndonjëri në Sigurim se filani ka filan libër. I nxora të tëra, bëra një kapicë me libra në mes të dhomës. Një javë të tërë kemi punuar me Nafijen. Atje, në vatrat e podrumit që ti e di, një javë të tërë kam djegur libra. Kjo m'i sillte, unë i shfletoja për të fundit herë, lexoja ndonjë gjë e pastaj i fusja në zjarr. Një javë të tërë, siç thash, dogja libra dhe një mot isha si i çmendur për atë që bëra. E bëra! Nuk desha të hy në burg".

Bibliotekat dhe monizmi

Periudha e njëmendësisë, e njohur si Koha e komunizmit, në Kosovë karakterizohet si periudhë iluzioniste, entuziaste, kozmopolite etj. U mor vesh, të gjitha këto, herë më shumë e herë më pak, varësisht prej

rrethanave politiko-shoqërore, do të rrjedhin pasoja afatgjatë në jetën tonë kulturore e shoqërore, ku bëjnë pjesë edhe bibliotekat.

Të gjitha bibliotekat e sotme në Kosovë, rreth 600, janë "produkte" të monizmit, prandaj veprimtaria e tyre, me prurjet e rëniet, është zhvilluar brenda kornizave të këtij sistemi totalitar. Me një fjalë çfarë ka qenë monizmi, të këtilla kanë qenë edhe bibliotekat tona.

Realisht shoqëria moniste nuk është marrë seriozisht me bibliotekat. Bibliotekave nuk iu ka dhënë vendi meritor në shoqëri, si "zemra e arsimit dhe edukimit njerëzor" (P. Buck). Sot e gjithë ditën bibliotekat trajtohen si servise brenda institucioneve, ku veprojnë. Po e zëmë, vitin që e lamë pas (2008), disa biblioteka në Kosovë, është dashur ta shënonin 50-vjetorin e themelimit të tyre, por kjo nuk ndodhi. Nuk u shënua as 50-vjetori i themelimit të bibliotekës së parë universitare në Kosovë, formuar më 1958 në Prishtinë, biblioteka e ish-Shkollës së Lartë Pedagogjike.

Edhe Ligji për bibliotekat (nr. 2003/16) këto institucione i sheh me sy prej njerke: injoron dijen e përvojën paraprake bibliotekare, thirrjet profesionale bibliotekare etj. "Biblioteka do të mbetet bibliotekë, pa marrë parasysh teknologjinë", thotë Mary Vasilakis, bibliotekare amerikane. Në mediat tona mungojnë debatet për bibliotekat, nuk formohet Dega e Bibliotekarisë, Instituti Bibliografik i Kosovës, bibliotekat nuk figurojnë në monografitë e institucioneve të ndryshme. Bile as në monografinë e Universitetit të Prishtinës 1970-1990" nuk haset asnjë fjalë për 28 bibliotekat universitare. Harrohet se biblioteka e shkollës është "organ i shkollës", ndërsa "jeta e një universiteti nuk mund të paramendohet pa bazën e tij shkencore-mësimore, ku, në radhë të pare, bëjnë pjesë bibliotekat".

Pa një qëndrim tjetër fare, bibliotekat tona nuk do të munden ta luajnë rolin e tyre adekuat arsimor, kulturor e shkencor në shoqërinë tonë pluraliste. Investimi në biblioteka është me efekte

largpamëse pozitive. "…Biblioteka do të mbetet e amshueshme", ka thënë Borghesi.

Hapja e Degës së Bibliotekarisë - domosdoshmëri

Reformat mësimore universitare janë procese të përhershme mësimore duke përfshirë këtu edhe hapjen e degëve të reja, sikurse është edhe Dega e Bibliotekarisë. Kjo lëndë sot ligjërohet në shumë universitete të Evropës e më gjerë.
Nevoja për kuadro të shkolluara bibliotekare në Kosovë është shumë e madhe.
Në vijim po japim lëndët kryesore të bibliotekarisë që ligjërohen në universitetet e Evropës: 1. Roli i bibliotekës në shoqëri si mjet komunikimi, 2. Parimet dhe metodat e rregullimit të materialit bibliotekar, 3. Parimet dhe metodat e hartimit të bibliografive, 4. Parimet dhe metodat e veprimtarisë referale, 5. Parimet dhe metodat e zgjedhjes, furnizimit, dhe përdorimit të materialit bibliotekar, 6. Parimet dhe metodat e udhëheqjes së bibliotekës, 7. Historia e bibliotekave dhe e librit, 8. Parimet dhe teknika e kërkimeve bibliotekare, 9. Parimet dhe metoda e projektimit, ndërtimit dhe pajisjes së bibliotekës, 10. Parimet dhe metodat e automatizimit të bibliotekës etj.
Bibliotekaria është informatikë. E "të jesh i informuar në mënyrë adekuate, do të thotë të jetosh në mënyrë efikase", ka thënë babai i informatikës moderne Norbert Wiener.

Biblioteka dhe politika

Bibliotekat në Kosovë, që nga formimi, janë përballur edhe me politizimin dhe instrumentalizimin e tyre. Në historinë me të re, me këtë sfida ato ndeshen që nga viti 1981, kur do të fillojë mënjanimi i literaturës së ardhur nga Shqipëria, madje edhe i librave të

kimisë, fizikës etj. Ndërsa do të kulmojë gjatë masave të dhunshme serbe 1990-1999. "Gjëja më e keqe është kur secila çështje bëhet politikë", ka thënë Edgar Moren.
Në vazhdën e këtij politizimi në Kosovë janë mbyllur e sakatosur rreth 300 biblioteka, tipash të ndryshme, në mesin e të cilave edhe Biblioteka Memoriale e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Prizren, degë e BKUK-së, biblioteka e parë private - publike "Liridoni" në Potërç të Klinës etj. Nga këto biblioteka janë flakur rreth 67000 njësi të materialeve bibliotekare: libra, periodike etj.
Politizimi i bibliotekave në Kosovë, neve, bibliotekarëve, sikur na zuri në befasi për rrethana të "jashtëzakonshme". Ne, në vend që të angazhoheshim në sfidimin e gjendjes së krijuar, me programe vepruese, sikurse u veprua në arsim, shëndetësi, ekonomi, sport etj., shkuam e u dhamë pas vajtimeve e të bërit sehir. "Ai që dëshiron të punojë, gjen forma. Ai që nuk dëshiron, gjen arsye", ka thënë Seneka. Përgjigjen më të mirë në këtë e ka dhënë bibliotekari slloven Toma Martelanc: "Ne, bibliotekarët, nuk jemi kompetentë që të japim diagnoza apo receta për të dalë nga kriza, por kemi për detyrë gjithsesi që t'i gjejmë rrugët më të mira dhe më efikase për përballimin e krizës në sferën tonë specifike".

LITERATURA:

Aleksandar Stipçeviq, Historia e librit, Prishtinë 1988,
Branka Furlan, Rad djeçjih shkolskih knjizhnica i njihov megjusobnih odnos. Drugi i Treçi Kongres Saveza Drushtava Bibliotekara F.N.R. Jugoslavije, Ljubljana 1958,
Dragan Baraq, Zbornik propisa o bibliotekarstvu u SFRJ, Novi Sad 1987
Tahir Foniqi, Tema nga bibliotekaria, Prishtinë 2003
XIII Skupshtina Saveza Drushtava Biblioteçkih Radnika Jugoslavije, Arangjelovac, maj 1990, Beograd 1990

DHJETË KRITERET PËR PASURIMIN E KOLEKSIONEVE TË BIBLIOTEKAVE

Sylejman Pireva*

Duke u bazuar në Ligjin për Bibliotekat 2003/6, përkatësisht në nenin 14, ku parashihen detyrat dhe roli i Këshillit Kombëtar të Bibliotekave, ky Këshill në mbledhjen e parë konstituive, na ka caktuar për të hartuar kriteret për mënyrën e pasurimit të koleksioneve të bibliotekave. Kemi identifikuar dhjetë kritere relevante, të cilat do t'u mundësonin Bibliotekave shërbime shumë më të mira dhe më efikase ndaj përdoruesve dhe të cilat janë të kushtëzuara nga përmbajtja e fondit librar, jo vetëm nga sasia, por edhe nga cilësia e tij.
Se çfarë është roli i bibliotekës publike, varet shumë, nga njohja, zotërimi dhe shfrytëzimi i kritereve për pasurimin e koleksioneve të saj. Ky proces është i përhershëm dhe i vazhdueshëm dhe për të qenë i tillë përveç posedimit të burimeve financiare, rëndësi të posaçme ka edhe

* Sylejman Pireva - drejtor i Bibliotekës Ndërkomunale "Hivzi Sulejmani" në Prishtinë. Kjo kumtesë është prezantuar më 17 prill 2008 në Bibliotekën Ndërkomunale të Gjilanit në sesionin me temën: "Bibliotekaria në Kosovë", gjatë Javës së Bibliotekës në Kosovë.

shfrytëzimi i këtyre kritereve. Ka ngjarë shpesh të ndeshim, në të kaluarën apo edhe në të tashmen, se jo të gjithë librat në koleksionet e bibliotekave kërkohen njësoj nga përdoruesit, qofshin këta libra të autorëve shqiptarë apo qofshin të autorëve të huaj, të përkthyer në gjuhën shqipe apo në origjinal. Madje gjatë procesit të revizionit, të spastrimit të koleksioneve nga librat që nuk kanë zgjuar interesim të përdoruesve, mund të kemi hasur ndonjë libër që nuk është kërkuar nga lexuesit me dhjetëra vjet. Prandaj si pasojë e këtij fakti kudo nëpër biblioteka do të mund të hasim në fondin aktiv dhe fondin pasiv të koleksioneve.

Kriteri i parë, marrja për bazë e numrit të banorëve të komunitetit që është një prej standardeve të IFLa-s, ku për kokë banori parashihet 1.5 - 2 libra. Nuk është e dobishme hapja e një biblioteke, veçanërisht kur ajo është publike, me një fond më të vogël se 2500 libra, sepse kostoja financiare do t'ishte shumë e lartë. Por jo vetëm për këtë, nuk mund të plotësohen në mënyrë të kënaqshme kërkesat dhe nevojat e përdoruesve sa dhe si duhet me më pak koleksione se kaq.

Kriteri i dytë, marrja për bazë e sipërfaqes dhe e hapësirës, si dhe e kushteve që ofron biblioteka për depozitim dhe ruajtje të koleksioneve. Këtu nuk na ndihmon aspak buxheti i mjaftueshëm, sado i pasur që të jetë, sepse e pamundësojnë hapësirat e kufizuara. Është e palejueshme që të pranohet mbingarkesë e koleksioneve kurse gjatë vendosjes së tyre të shkilen rregullat bibliotekare, duke formuar nga dy rende nëpër rafte ose duke i lënë nëpër pako.

Kriteri i tretë, shkalla e arsimimit dhe emancipimit të komunitetit që kërkon zgjedhjen dhe përshtatjen e literaturës në përputhje me të. Nuk është njësoj si kur blihen libra për pasurim të koleksioneve të një biblioteke në një mjedis rural, si të një biblioteke në një mjedis urban, apo si kur planifikon për një komunitet joakademik, si për një komunitet akademik-universitar. Duhet pasur parasysh mjedisi, veprimtaritë e q] zhvillohen atje, heterogjeniteti, kërkesat e veçanta etj.

Kriteri i katërt, ka të bëjë me dallimin midis moshave dhe gjeneratave përbrenda komunitetit. Këtu kemi parasysh moshat e ndryshme si:

parashkollorët, filloristët, nxënësit e shkollës së mesme, studentët, punëtorët, intelektualët, pensionistët etj. Natyrisht këtu nuk mund të bëhet fjalë për kufij absolutë të respektueshëm në mes këtyre moshave, prandaj as të koleksioneve për ta, sepse do të ketë edhe gërshetim moshash dhe si pasojë e kësaj edhe gërshetim koleksionesh, por megjithatë është mirë të respektohet në masë të konsiderueshme, pasi ekziston dallimi psikologjik nga kapërcimi prej moshe në moshë.

Kriteri i pestë, marrja parasysh e diversitetit kulturor dhe gjuhësor të komunitetit. Në shoqëritë demokratike, bibliotekat, veçmas ato publike, luajnë një rol tepër të rëndësishëm në edukimin dhe emancipimin e grupeve etnike në një mjedis të caktuar, pikërisht përmes përhapjes së librit, gazetave, revistave si dhe materialeve dhe formave të tjera. Për këtë arsye duhet respektuar dhe shfrytëzuar këtë kriter me përgjegjësi në të gjitha momentet kur bëhet fjalë për pasurimin e koleksioneve të bibliotekës, duke ju siguruar materiale brenda dhe jashtë vendit. Kjo mund të arrihet më lehtë duke bashkëpunuar me përfaqësuesit e këtyre grupeve.

Kriteri i gjashtë, kujdesi nga nënçmimi i krijimtarisë vendore, kombëtare dhe mbiçmimi i krijimtarisë botërore. Fjala është për respektimin e vlerave të krijimtarisë së autorëve vendorë, të vlerësuar nga studiuesit dhe përdoruesit e bibliotekave, por pa e lënë anash edhe krijimtarinë e autorëve të huaj.

Kriteri i shtatë, kërkesa për ndryshimin e procedurave të tenderimit për blerje të librit. Kjo formë e përcaktuar për blerje të librit për të pasuruar fondin e koleksioneve të bibliotekave, është bërë një pengesë serioze në fushën e pasurimit të koleksioneve të bibliotekave. Tenderi imponon kufizim kohor, pasi je i detyruar të respektosh afatin e tij, të parashohësh në radhën e librave të porositur shumë herë edhe libra që as i njeh, as ke dëgjuar për ta dhe as që meritojnë të zënë vend në raftet e bibliotekës. Kësisoj puna më e rëndësishme gjatë vitit, bëhet formalisht, sa për të plotësuar kuotën e paracaktuar nga punëdhënësi ose dikush tjetër. Respektimi i procedurës së tenderit pamundëson blerjen e librave të

dëshiruar, kur dihet se librat vazhdojnë të botohen gjatë gjithë kohës, kurse tenderi shpallet më rrallë, mbase asnjëherë në vjet.

Kriteri i tetë, hulumtimi i opinionit me propozimet dhe kërkesat e shtruara, është njëri ndër kriteret shumë të rëndësishëm që mundëson procesin e pasurimit të koleksioneve të bibliotekës në rrugë më të sigurt dhe më pak të gabueshme. Kjo formë realizohet më së miri përmes anketave së përgatitura me shkrim, duke ua ofruar përdoruesve gjatë qëndrimit në sallë të leximit apo edhe përdoruesve të tjerë gjatë huazimit të librit. Anketa mund të përfshijë të gjitha fushat e krijimtarisë letrare, shkencore etj. që kjo t'iu mundësojë atyre për t'u shprehur për llojin e literaturës së dëshiruar. Anketa mund të realizohet edhe nga distanca, pasi ekziston edhe rruga tjetër shumë efikase, që qytetarët propozimet e tyret t'i dërgojnë përmes postës elektronike. Edhe forma e intervistës me qytetarët, mund të jetë një mundësi e mirë për të marrë mendimin dhe propozimin e tyre për librat që ata mendojnë se janë të nevojshëm për bibliotekën, e që asaj i mungojnë në koleksionet e veta.

Kriteri i nëntë, do të marrë për bazë formën e njohur dhe të përdorur prej të gjitha bibliotekave, pasurimin e koleksioneve përmes dhurimit të librit nga individë, familje apo institucione, që është i mirëseardhur, por jo gjithherë ideal, sepse jo të gjithë librat që i dhurohen bibliotekave, janë pikërisht ata që zgjojnë interesimin e përdoruesve. Prandaj bibliotekarët duhet të mbajnë qëndrim të tillë që të mos pranojnë çfarëdo lloji të literaturës dhe pa asnjë seleksionim, qoftë edhe kur kjo vjen falas, sepse kështu vetëm sa do të ngarkohen kot raftet me libra.

Kriteri i dhjetë, ka të bëjë me spastrimin e koleksioneve. Ky në shikim të parë na duket sikur bie në kundërshtim me kriteret e tjerë që kanë të bëjnë me pasurimin, por jo, sepse sado që ky nuk ka të bëjë drejtpërdrejt me pasurimin e koleksioneve, është formë po aq e rëndësishme sa edhe vetë pasurimi, sepse në këtë mënyrë bëhet shkarkimi i rafteve nga librat e pashfrytëzuar, duke ua liruar vendin librave të rinj dhe të merituar.

DISA ÇËSHTJE ME RËNDËSI NË NDËRTIMIN DHE ZHVILLIMIN E FONDEVE LIBRARE NË KOSOVË

(Realiteti dhe perspektiva)

Hajrullah Mustafa*

Ndërtimi i fondeve dhe zhvillimi i koleksioneve në bibliotekari është faktori kryesor dhe vendimtar në funksionimin dhe afatizimin pozitiv të kësaj sfere pa të cilin jo që nuk mund të flitet por as të mendohet krijimi, avancimi, si dhe inkuadrimi i sistemit bibliotekar të Kosovës në rrjedhat e bibliotekarisë perëndimore.

Është e vërtet se ndërtimi i fondeve bibliotekare është një proces multidimensional dhe mjaft kompleks, dhe kërkon kohë të gjatë për të elaboruar, prandaj unë në kuadër të kësaj kumtese do të ndalem vetëm në një dimension të tij, pra vetëm në dimensionin e zhvillimit të Koleksioneve, duke e vështruar këtë në realitetin e tanishëm por edhe në realitetin perspektiv të Republikës së Kosovës.

* Hajrullah Mustafa - drejtor i Bibliotekës Ndërkomunale "Latif Berisha" në Mitrovicë. Kjo kumtesë është prezantuar më 17 prill 2008 në Bibliotekën Ndërkomunale të Gjilanit në sesionin me temën: "Bibliotekaria në Kosovë", gjatë Javës së Bibliotekës në Kosovë.

Bibliotekaria e Kosovës ka një histori dhe traditë të gjatë të zhvillimit, por gjithherë u ballafaqua me katrahurat dhe sfidat që u ballafaqua dhe e përcollën tërë popullin e Kosovës gjatë zhvillimit historik, deri në luftën e fundit në Kosovë. Deri në këtë kohë, përkundër përpjekjeve dhe sakrificës së punonjësve bibliotekarë për ndërtimin e fondeve bibliotekare të mirëfillta, dhe shumë të kërkuara nga përdoruesit, ishin pengesë faktorët politikë, të cilët nuk lejonin ngritjen e kualitetit të këtyre fondeve. Deri në këtë kohë, bibliotekaria, politika botuese dhe libri, posaçërisht ai shqip jo vetëm që nuk kishte tretmanin e duhur në shoqëri, por pengohej dhe persekutohej në mënyrat më të ashpra dhe johumane e jocivilizuese. Prandaj edhe fondet librare ishin jo aktuale dhe jo aq të kërkuara nga përdoruesit. Në realitetin e ri të Kosovës pas luftës së fundit, d.m.th nga qershori 1999 e tutje u bënë hapa pozitiv në ndërtimin dhe organizimin e fondeve librare të Kosovës, edhe pse mendoj se ka hapësirë të punohet edhe shumë më tepër në këtë aspekt, duke u shfrytëzuar dhe involvuar shumë më tepër të arriturat shkencore të lëmenjve të bibliotekarisë, por edhe duke shfrytëzuar përvojat më të begatshme të vendeve më të përparuara të perëndimit. Po ashtu duhet që shoqëria përkatësisht institucionet e Republikës së Kosovës të përkrahin dhe të kenë qasje shumë më të tepër se tani, ndaj Bibliotekave, librit, politikës botuese, pasi që ndërtimi dhe organizimi i fondeve librare është dhe duhet të jetë një proces permanent, i pandërprerë dhe i përhershëm.

Në kuadër të këtij procesi ka shumë elemente që do të bënin një fond librar të qëndrueshëm, të shfrytëzuar dhe aktual, por unë do të përmend vetëm një, nga tërë mekanizmi i ndërtimit dhe organizimit të fondeve librare e ai është Pasurimi dhe zhvillimi i koleksioneve. Mendoj se pa ngritjen dhe avansimin e këtij dimensioni, Biblioteka jo që nuk mundet që të funksionojë dhe kryejë obligimin dhe përgjegjësit e veta para bashkësisë por edhe do të humbë kuptimin e vet.

Prandaj realiteti i ri i krijuar në Kosovë kërkon qasje dhe trajtim të ri ndaj këtij dimensioni të bibliotekarisë së Kosovës. Kujtoj se është mëse e domosdoshme që në biblioteka të ketë, nëse jo ekip, bile person i cili do të merret vetëm me çështjen e pasurimit të fondeve dhe i cili në mënyrë profesionale do të përcjellë, planifikojë dhe propozojë kahet dhe mënyrat e pasurimit dhe zhvillimit të fondeve librare, gjithherë i orientuar dhe i pozicionuar kah aktualiteti i fondeve, kah kërkesat e përdoruesve. Një orientim i tillë padyshim do të ndikonte që bibliotekat posaçërisht mendoj në ato publike, nuk do të ngarkonin hapësirat e tyre edhe ashtu shumë të vogla, me koleksione pak të kërkuara nga përdoruesit, dhe në mënyrë shumë më racionale dhe ekonomike do të shfrytëzoheshin burimet financiare edhe ashtu të vogla dhe simbolike me pasurimin e fondeve librare.

Personeli i angazhuar për pasurimin e fondeve gjithherë do të jetë në rrjedhat e informacioneve që dalin nga biltenet dhe bibliografit rrjedhëse, katalogët e furnitorëve, recizionet në revista dhe gazeta të ndryshme, panairet e librave etj., por edhe kërkesat dhe nevojat e shfrytëzuesve, me qëllim që pasurimi i fondit të jetë sa më aktual, sa më i qëndrueshëm dhe sa më i kërkuar nga përdoruesit e bibliotekës.

Në praktiken bibliotekare në Kosovë, është vërejtur se në pasurimin e koleksioneve, në mungesë të fondeve buxhetore primare, siç janë ato nga qeveria e shtetit janë kyçur dhe angazhuar edhe shumë donatorë, kontributi i të cilëve ishte dhe do të jetë shumë i çmuar. Në fund të fundit edhe Udhëzimet e IFLA-s na obligojnë që ne të mbajmë kontakt dhe të bashkëpunojmë me donatorët dhe miqtë e bibliotekës. E konsiderojmë si shumë të rëndësishme monitorimin e tyre në projektet e tilla, por nuk e arsyetoj anashkalimin e punonjësve të bibliotekës në përzgjedhjen e koleksioneve, pasi që këta të fundit janë ata që më së miri e dinë se çka i mungon dhe çka i duhet bibliotekës. Prandaj në këto raste dona-

torët duhet të jenë monitorues e jo edhe determinues dhe përcaktues në pasurimin e fondeve librare të bibliotekës, sepse këtë duhet dhe më së miri mund ta bëjnë punonjësit profesional të bibliotekës. Pothuajse diçka e ngjashme ndodh edhe te dhurata si formë e pasurimit të fondeve librare. E po kështu shpesh në praktikën bibliotekare ballafaqohemi edhe në vështirësi administrative të tenderimeve ku ndikimi i punonjësve profesionalë të bibliotekave me shumë vështirësi aplikohet në përzgjedhjen e koleksioneve që kanë për qëllim pasurimin e fondeve librare të bibliotekave.

Prandaj, duke elaboruar këtë çështje me rëndësi në bibliotekarin e Kosovës, mund të nxjerrim këto rekomandime:

Zhvillimi dhe pasurimi i koleksioneve është faktori më prioritar në funksionimin dhe avancimin pozitiv të bibliotekave dhe se çdo ngecje në këtë aspekt është rënie e imazhit dhe rolit të bibliotekës para bashkësisë në të cilën vepron.

Për të pasur sukses në këtë sferë, biblioteka duhet të posedojë fonde buxhetore primare, stabile dhe të qëndrueshme e jo të presë vetëm nga ato sekondare se a do të ketë apo jo donatorë, se a do të ketë apo jo dhurata etj.

Duhet që në kuadër të çdo biblioteke të jetë personeli shumë i ngritur profesionalisht, i cili do të merret me këtë çështje shumë të rëndësishme, duke hulumtuar dhe përcjellë burimet e informacioneve të shumta në mënyrë që fondet librare të pasurohen gjithherë me koleksione të reja, aktuale dhe të kërkuara nga përdoruesit.

Personeli i cili do të merret me pasurimin e koleksioneve duhet të ketë informacione shumë të qarta mbi fondin me të cilin posedon biblioteka, mbi rrjedhat e koleksioneve të reja, të korrespondojë dhe të jetë urë lidhjeje më kërkesat dhe nevojat e përdoruesve të bibliotekës, dhe gjithherë duke u bazuar në këto informacione të hartojë planin për pasurimin e koleksioneve, kuptohet duke

vepruar gjithherë konform fondeve buxhetore me të cilat posedon biblioteka.

Prandaj shpresoj se këto rekomandime të cekura më lartë, por edhe gjithë ky debat i sotëm nga ekspertët dhe njohësit më të denjë të bibliotekarisë në Kosovë, kanë për qëllim të grisin dhe provokojnë pozitivisht vëmendjen e institucioneve shtetërore të Kosovës, për një tretman përkrahje më të madhe të bibliotekave nga tani dhe në të ardhmen, sepse pa mbështetje dhe përkrahje pikërisht buxhetore, bibliotekat nuk mund të kryejnë rolin dhe funksionin që kanë në shoqëri, që të përcjellin trendet e shpejta dhe dinamike të dijes, shkencës dhe teknologjisë të informacioneve sot në botën bashkëkohore; të jetë në shërbim të qytetarëve, por edhe të futen në rrjedhat e civilizimit perëndimor.

TEMATIKA E BOTIMEVE NË KOSOVË GJATË VITIT 2007

Shqipe Asllani &
Shkëndije Berisha*

Në rrethanat e një realiteti kulturor e politik në formim, karshi dijeve, kulturës e arsimit, në Kosovë vijon me një dinamikë në rritje edhe kultura e botimit, në kuptimin sasior e cilësor. Pra, në këtë kontekst, kur trendët e kulturës e të arsimit i përcaktojnë edhe botimet - formatet dhe llojet e botimeve, në njërën anë, dhe tematika e tyre, në anën tjetër, do të ishte e rëndësishme që, nëpërmjet një analize të të dhënave, që tashmë janë bërë, nga Shërbimi i CIP-it (Katalogimi në botim), të japim një vështrim se çfarë botohet, përkatësisht cilat fusha e dominojnë tregun e botimeve në Kosovë.

Meqë puna dhe aktiviteti ynë është i lidhur me CIP-in, një shërbim përpunimi të njësive libër në botim, arrijmë të marrin, në të njëjtën

* Shqipe Asllani dhe Shkëndije Berisha janë përgjegjëse të Sektorit të CIP-it, të Departamentit të Katalogimit në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Kjo kumtesë është prezantuar më 17 prill 2008 në Bibliotekën Ndërkomunale të Gjilanit në sesionin me temën: "Bibliotekaria në Kosovë", gjatë Javës së Bibliotekës në Kosovë.

kohë, informacionin dhe të përcjellim gjithë veprimtarinë botuese në Kosovë - të njësive libër. Përcjellja specifike e veprimtarisë botuese në Kosovë, nëpërmjet përcaktuesve të fushave në të cilat botohet : tematik, gjuhësor, akademik etj, jep një pamje të qartë për botimet dhe profilin e botuesve, të cilët diktohen dhe diktojnë aspekte të zhvillimit arsimor dhe kulturor të Kosovës gjatë këtyre viteve të pasluftës.

Në këtë analizë të botimeve gjatë vitit 2007 në Kosovë, sipas KUD-it, (ndarjes lëndore), informacioni i organizuar sipas statistikave, jepen sasitë në numër dhe përqindje të botimeve në secilën fushë. Krahas kësaj, kemi përcaktuar edhe të dhëna që krahasohen, të botimeve në nivele e kritere të ndryshme, që kemi konsideruar të jenë të vlefshme për opinionin kulturor në Kosovë, duke i marrë si statistika – vërtetësia e të cilave mundëson një interpretim.

Të dhënat tregojnë se gjatë vitit 2007, botimet në Kosovë, (fjala është për botimet që e marrin CIP-in në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës), janë të larmishme - u përkasin fushave të ndryshme. Në vitin 2007 , janë botuar 600 tituj. Pra, kjo shifër e dhënë për numrin e botimeve për rreth një vit, është për botimet që kanë marrë dhe CIP-in dhe numrin e ISBN-së në BKUK gjatë vitit 2007. Mirëpo ende një numër i botimeve dalin pa CIP dhe ISBN, edhe pse përgjegjësia e botuesve në Kosovë, për t'i pajisur botimet e tyre me këta identifikues është rritur.

Para se të japim më poshtë të dhënat për botimet nëpër fusha - klasifikuar sipas tabelës së KUD-it, duhet thënë se jo pak tituj, që botohen, pra që marrin CIP-in në Bibliotekën Kombëtare, kanë përmbajtje të përzier dhe marrin dy e më tepër indekse dh.m.th numra të klasifikimit ; përmbajta e librave përcaktohet përmes indekseve të fushave e të dijeve të ndryshme. Gjatë kësaj analize ne jemi referuar gjithmonë indeksit të parë.

Në vijim po japin numrin e titujve të botuar në Kosovë (pra që kanë marrë CIP) gjatë vitit 2007, sipas tabelës së klasifikimit :

Fusha 0Çështje të përgjithshme. Shkenca dhe dituria. Organizimi. Informacioni, janë klasifikuar gjegjësisht botuar - 21 tituj;
Fusha 1Filozofia. Psikologjia - 18 tituj;
Fusha 2Feja. Teologjia - 32 tituj;
Fusha 3Shkencat shoqërore - 116 tituj;
Fusha 5Matematika dhe shkencat e natyrës - 59 tituj;
Fusha 6Shkencat e aplikuara. Mjekësia. Teknologjia - 23 tituj;
Fusha 7Artet. Muzika. Sporti - 40 tituj;
Fusha 8Gjuhësia. Letërsia - 234 tituj;
Fusha 9Gjeografia. Biografia. Historia - 57 tituj.

Mbështetur në të dhënat e mësipërme, mund të konstatohet se gjatë vitit 2007, janë botuar tituj që u përkasin të gjitha fushave të dijes.

Dominojnë botimet nga Gjuhësia dhe Letërsia, 39%, e botimeve të përgjithshme;
nga Shkencat shoqërore - 116 tituj ose 19.3 %;
nga Shkencat natyrore - 59 tituj ose 9.8% etj.. ndërsa
më së paku është botuar nga Filozofia - 18 tituj ose 3%.

Bazuar në dhënat e lart përmendura janë bërë disa krahasime në mes të profileve të fushave.

Gjuhësia dhe Letërsia. Dallimi është i theksuar, po ashtu, mes Gjuhës, në njërën anë, dhe Letërsisë, në anën tjetër. Nga gjuhësia janë botuar 36 tituj ose 6 %, ndërsa nga Letërsia - 198 tituj ose 33%.

Letërsi e huaj (e përkthyer në gjuhën shqipe) janë botuar 24 tituj ose 4%; ndërsa letërsi për fëmijë – janë botuar 31 tituj ose 5.1%.

Nëse krahasohen botimet shkollore dhe botimet universitare atëherë dallimi këtyre profileve të botimeve është po ashtu i theksuar.

Tekstet universitare dhe shkollore gjithsej janë 199 tituj ose 33.1%, prej tyre Tekste shkollore janë - 188 tituj ose 31.3%, ndërsa Tekste universitare janë 10 tituj ose 1.6 %

Botuesit - numri i titujve dhe profili.

Në Kosovë, Shtëpitë botuese, karshi Institucioneve botues dhe Autorëve botues, dominojnë në kuptimin sasior në tërësinë e botimeve. Prej të gjitha kategorive të botuesve, të cilët kanë botuar

gjatë vitit 2007, Shtëpitë botuese private prijnë me 506 tituj të botuar, ose 84.3% të të gjitha botimeve, Institucionet si botues p. sh. Akademia e Shkencave , Fakultetet, Instituti Albanologjik dhe institucionet e tjera kanë botuar 8.5% ose 51 tituj, botues individual janë 7.1% ose 43 tituj të botuar.

Shkencat e natyrës/Shkencat shoqërore. Nëse krahasojmë numrin mes botimeve në Shkencat e natyrës dhe Shkencat shoqërore, del se në Shkencat shoqërore, shkencat e përgjithshme, filozofia, feja, historia, janë botuar 244 tituj ose 40.6%, kurse në Shkencat e natyrës dhe ato të Aplikuara – janë botuar 82 tituj ose 13.6% ?
Botuesit - numri i titujve dhe profili. Në Kosovë, Shtëpitë botuese, karshi Institucioneve botues dhe Autorëve botues, dominojnë në kuptimin sasior tërësinë e botimeve. Gjithnjë duke iu referuar të dhënave për botimet në Kosovë që marrin CIP-in, gjatë vitit 2007, me 15.8% të të gjitha botimeve është "Libri Shkollor", shumica dërmuese e botimeve të kësaj shtëpie botuese janë tekste shkollore, më pas vjen "Dukagjini" me 7.6 % të botime; kjo shtëpi përshin botime me karakter dhe moshash të ndryshme. Pastaj vijnë botuesit që janë të profilizuar kryesisht në fushat dhe zhanret e arteve, përgjithësisht të letërsisë. Ndër botuesit e këtij profili që i dominojnë botimet në Kosovë janë Shtëpia botuese "Faik Konica" me 4.5% botime, Shtëpia botuese "Rozafa" me 3.1% etj. Prej Institucioneve botues, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës merr pjesë në numrin e përgjithshëm me 1.6 % të botimeve, Universiteti i Prishtinës me 10 tituj ose 1.6 %, Instituti Albanologjik i Prishtinës - me 1.3 % etj; ndërsa, universitet private kanë botuar 10 tituj ose 1.6% të të gjithë tekste universitare.
Prej të gjitha kategorive të botuesve, të cilët kanë botuar gjatë vitit 2007, Shtëpitë botuese private prijnë me 506 tituj të botuar, ose 84.3% të të gjitha botimeve, Institucionet - si botues, janë gjithsej 9 me 8.5% ose 51 tituj, ndërsa botues individualë janë 7.1% ose 43 tituj të botuar.

BIBLIOTEKARIA SHQIPTARE NË LUGINËN E PRESHEVËS

Xhemaledin Salihu*

Histori e shkurtër

Fillet e bibliotekarisë në Preshevë datojnë qysh në shekullin XIX, kur në qendër të qytetit ekzistonte Biblioteka me Leximore. Biblioteka e parë në Preshevë u themelua më 15 maj të vitit 1945. Sipas shënimeve të gjetura, në Preshevë për herë të parë blihet libri shqip në vitin 1964. Gjatë viteve 1956-1965, veprimtarinë bibliotekare e karakterizon ekzistimi i Bibliotekave Familjare, të cilat luanin rolin dhe funksionin e bibliotekave publike.
Në Preshevë, më 1965 themelohet Biblioteka Publike "Presheva", e cila më 1966 shndërrohet në Bibliotekë Amë, për të gjitha bibliotekat e komunës së Preshevës. Më 1972 hapen degët e Bibliotekës Amë në Rahovicë, Miratoc, Leran dhe Caravajkë.

* Xhemaledin Salihu është shef i Bibliotekës në Preshevë. Kjo kumtesë është prezantuar më 17 prill 2008 në Bibliotekën Ndërkomunale të Gjilanit në sesionin me temën: "Bibliotekaria në Kosovë", gjatë Javës së Bibliotekës në Kosovë.

Biblioteka Amë në periudhën 1969-1980 punoi dhe veproi në lokalet e ndërtesës së vjetër të Universitetit të Punëtorëve, në kuadër të të cilit ishte njësi punuese. Lokali i saj kishte një sipërfaqe prej 36 m2 dhe nuk kishte sallë leximi.
Shënimet arkivore flasin se në Bujanoc, në vitin 1946/47 ekzistonte Biblioteka Popullore e Qytetit.
Në Tërnoc ekzistonte një Bibliotekë Popullore me Leximore dhe puna zhvillohej në lokalet e shkollës. Po ashtu edhe në fshatrat Bilaç, Breznicë, Lluçan, Letovicë, Nasalcë, Muhoc, Samolicë, Turi, ekzistonin bibliotekat me apo pa Leximore.
Gjatë viteve 1953-54 u themelua Biblioteka e Rrethit me seli në Bujanoc.
Për historinë e bibliotekarisë në Medvegjë nuk gjetëm shënime, andaj edhe nuk po shkruajmë.

Gjendja e tanishme

Në komunën e Preshevës, veprimtarinë bibliotekare e kryejnë Biblioteka Amë në Preshevë, degët e saja në Rahovicë, Miratoc dhe Leran, Biblioteka e Gjimnazit, e Shkollës së Mesme Teknike, Biblioteka e Shkollës fillore "15 Nëntori"në Preshevë, Biblioteka e Shkollës fillore në Corroticë, Biblioteka private "Dhurata" në Tërnavë, Biblioteka Islamike në Preshevë dhe disa Biblioteka Familjare.
Që nga viti 1981, Biblioteka Amë punon në lokalet e reja të Shtëpisë së kulturës, njësi e së cilës është që nga themelimi i saj. Tentativa e parë për pavarësimin e saj u bë në vitin 1996, pas nxjerrjes së Ligjit mbi Bibliotekat, sipas të cilit Ligj, Bibliotekat duhej të pavarësoheshin nga Institucionet të tjera kulturore. Edhe pse Ligji aplikoi afatin e themelimit të Bibliotekave Komunale, në Preshevë, pavarësimi i saj nuk kaloi në seancën e Kuvendit komunal.

Aktualisht Biblioteka është e vendosur në një lokal improvizues në Shtëpinë e kulturës prej 65 m2 dhe nuk i plotëson as nevojat elementare të veprimtarisë. Kjo zgjidhje është e përkohshme. Në rafte është shpërndarë vetëm lektura e shkollës fillore dhe e asaj të mesme si dhe punohet kryesisht me lexuesit e kësaj moshe.
Këtë vit nga buxheti komunal i Preshevës janë ndarë 800.000 dinarë për ndërtimin (rekonstruktuimin) e Bibliotekës në katin e dytë të Shtëpisë së kulturës. Projektin ideor dhe skicën e Bibliotekës e bëri autori i kësaj kumtese, paraprakisht u konsultua me Bibliotekë Ndërkomunale "H. Sulejmani" dhe Bibliotekën Kombëtare në Prishtinë, si dhe mori pëlqimin Bibliotekave Popullore në Vranjë dhe të asaj në Beograd. Bile, Biblioteka Popullore e Serbisë në Beograd e dha rekomandimin që sipas këtij propozimi të bëhet projekti i Bibliotekës në sipërfaqe prej 450 m2. Sipas projektit janë paraparë: Drejtoria, Sektori për Pasurimin dhe Përpunimin e Materialit Bibliotekar, Sektori për Fëmijë me Sallë Leximi, Sektori i Huazimit për të Rritur, në të cilin do të vendosen 3 punkte të Internetit, për përdoruesit e Bibliotekës, Sektori i Koleksioneve të Trashëgimisë dhe të Vendit, Salla e Leximit me Periodikun dhe me nga 1 ekzemplar të Koleksioneve Shkencore, Sektori i Koleksioneve Shkencore dhe Depoja. Tenderi për ndërtim ka përfunduar dhe kanë filluar punët në ndërtimin e Bibliotekës Komunale Publike, e cila sipas ekspertëve do të jetë Biblioteka më moderne në rajon.
Tashti Fondi i Përgjithshëm i Koleksioneve në Bibliotekën Amë është 19.570 tituj me 63.700 libra dhe publikime të tjera. Koleksionet janë të përpunuara në mënyrë profesionale, sipas Klasifikimit Decimal Universal. Biblioteka ka të formuar Skedarin Alfabetik dhe Sistematik. Koleksionet, kryesisht janë në gjuhën shqipe, por ka libra edhe në serbisht, bullgarisht, anglisht dhe gjuhë rome.
Puna me lexues bëhet ende në mënyrë klasike, inventarizimi po ashtu, vetëm katalogimi punohet në kompjuter.

Biblioteka dhe koleksionet e saja janë të hapura dhe publike për përdoruesit.
Në Bibliotekën Amë janë të punësuar katër bibliotekarë. Biblioteka në Rahovicë posedon lokalin e ri dhe modern, në ndërtesën e Bashkësisë lokale dhe koleksionet e saja janë në gjuhën shqipe dhe janë të përbëra prej 11.487 vëllimeve. Aty punon një librar.
Biblioteka në Miratoc posedon koleksionet prej 9.774 librave. Është e vendosur në lokalet e shkollës fillore dhe punon një bibliotekar. Biblioteka në Leran posedon koleksionet prej 14.518 librave, është e vendosur në lokalet e shkollës fillore dhe punon një bibliotekar.
Numri i përgjithshëm i librave në Biblioteka është 99.476 libra, sipas së cilës secilit banorë i kemi siguruar nga 2 libra.
Biblioteka e Qytetit të Bujanocit supozohet të jetë themeluar në vitin 1948, ndërsa si institucion i pavarur bibliotekar themelohet në vitin 1995, sipas Ligjit mbi Bibliotekat. Lokalet e para të Bibliotekës kanë qenë në ish ndërtesën e kinemasë në Bujanoc. Biblioteka veprimtarinë e saj e zhvillonte në kuadër të Universitetit të Punëtorëve në lokale shumë të ngushta. Kushtet ideale për punë Biblioteka i krijon me kalimin e saj në godinën e re të Shtëpisë së Kulturës, në vitin 1982, ku edhe sot zhvillon aktivitetin e saj.
Biblioteka nuk është e ndarë në sektorë pune, por posedon lokale të kënaqshme me Sallë Leximi, ku anëtarët dhe qytetarët e Bujanocit mund të lexojnë shtypin e përditshëm dhe atë periodik.
Biblioteka e Bujanocit posedon koleksionet prej 43.540 librave. Koleksionet në gjuhën shqipe u pasuruan katër vjetët e fundit, sepse deri atëherë kjo bibliotekë kishte koleksionet vetëm në gjuhën serbe.
Biblioteka e Tërnocit posedon koleksionet prej 7.980 librave dhe ajo e Muhocit ka 8.360 libra në gjuhën shqipe.

Në Bibliotekë janë të punësuar 12 punëtorë: drejtori, dy bibliotekarë, katër librarë të lartë, tre librarë dhe 2 punëtorë ndihmës.
Biblioteka, pos aktiviteteve bibliotekare, zhvillon edhe aktivitete kulturore-arsimore: organizon mbrëmje letrare, promovime librash, ekspozita të librave, si dhe aktivitete të tjera kulturore.
Biblioteka e Qytetit posedon hapësirë prej 366 m2 dhe ka këto sektorë: Sektori për të Rritur, Leximorja për Fëmijë dhe të Rritur, zyret dhe depoja e fondeve të librave.
Në Medvegjë ekziston Biblioteka komunale që sa për formalitet ka koleksione të pakta librash në gjuhën shqipe. Kështu është gjendja edhe në bibliotekën e Banjës së Siarinës, ku jetojnë shqiptarë.
Biblioteka e Tupallës posedonte koleksione prej 700-800 librash, ndërsa ajo e Banjës së Siarinës kishte koleksione prej 3.000-4.000 librash.
Bibliotekat shkollore të Tupallës dhe të Banjës së Siarinës dhe ajo e qytetit posedonin koleksionet prej 7.000 librave, në gjuhën shqipe edhe atë me botime të vjetra dhe lekturë shkollore. Për fatin e këtyre koleksioneve të bibliotekave të përmendura pas Luftës nuk dihet, mund të jenë shkatërruar të gjitha.
Në bibliotekat e komunës së Medvegjës nuk ishte i punësuar asnjë shqiptar, pos që ato shkollore i udhëhiqnin arsimtarët e shkollave.

Detyrat e ardhshme

Detyrat themelore dhe prioritare në zhvillimin e Bibliotekarisë shqiptare në Luginë të Preshevës janë:
- Vendosja e Bibliotekave në hapësira të mjaftueshme, të cilat i plotësojnë kushtet dhe kriteret për punë normale të veprimtarisë bibliotekare informative;
- Themelimi i Bibliotekave komunale publike në Preshevë e Medvegjë (në Tupallë apo Banjë të Sijarinës, në gjuhën shqipe);
- Themelimi i Bibliotekave në Bashkësi lokale, shkolla fillore e të mesme;

- Formimi i Sektorëve të domosdoshëm për punë, sipas nevojave të Bibliotekave komunale, sidomos formimi i Sektorit të Trashëgimisë dhe Koleksioneve të Vendit dhe Sektori i Periodikut;
- Formimi i Skedarit Alfabetik dhe atij Sistematik;
- Pasurimi dhe përtëritja e koleksioneve me tituj të rinj nga lëmi të ndryshme, sidomos më gjuhën shqipe;
- Përpunimi profesional i materialit bibliotekar;
- Automatizimi i veprimtarisë bibliotekare (kompjuter, etj.);
- Lidhja e bibliotekave komunale me internet;
- Revizionet e herëpashershme në Biblioteka, dhe;
- Fondet e hapura, me qasje të lirë për përdoruesit e Bibliotekave.

Perspektiva e bibliotekarisë shqiptare

Duke pasur parasysh shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, integrimet territoriale dhe shpirtërore në Evropë; synimet tona për bashkim kombëtar, shpirtëror dhe territorial; duke u nisur nga e drejta ndërkombëtare e barabartë e çdo qytetari dhe bashkësie etnike në ekonomi, arsim e kulturë; nga qëllimet themelore për një autonomie politike në artikulimin, mbrojtjen dhe prezantimin e interesave themelore të Shqiptarëve të Luginës së Preshevës; duke pasur parasysh specifikat politike, ekonomike, sociale e kulturore të Shqiptarëve të Luginës së Preshevës; nevojën e nxjerrjes së Ligjit republikan mbi Rajonalizimin, me të cilin Lugina e Preshevës duhet të konstituohet Rajon, me nivelin kushtetues, që siguron ingerenca të posaçme politike, juridike, ekonomike, sociale, kulturore, politike, arsimore, shëndetësore, gjyqësore, dhe duke pasur parasysh multietnicitetit e saj, progresin dhe prosperitetin e mëtejmë të shqiptarëve së Luginës propozojmë :

Krijimin e Hapësirës së Përbashkët Mbarëshqiptare Bibliotekare Informative dhe sigurimin e Lidhjes Speciale të Bibliotekarisë shqiptare të Luginës me Bibliotekarinë e Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë:

Qarkullimi i lirë i të Mirave Bibliotekare Informative Luginë-Kosovë-Shqipëri dhe anasjelltas;

Lidhja dhe sigurimi i lidhjes së sistemit bibliotekar informativ me sistemet bibliotekare informative të Kosovës dhe Shqipërisë;

Pjesëmarrja e Punonjësve bibliotekarë të Luginës në Konferenca bibliotekare, manifestime, panaire librash, ekspozita, trajnime, kurse, vizita, binjakëzime e forma të tjera të aktivitetit kulturor e arsimor;

Përfaqësimi i punonjësve bibliotekarë të Luginës së Preshevës në Këshillin Nacional të Bibliotekave të Kosovës, në Kryesinë dhe Kuvendin e Shoqatës së Bibliotekarëve të Kosovës.

Themelimin e Bibliotekës Popullore Rajonale me seli në Preshevë. Biblioteka në fjalë do ta kryente funksionin e Bibliotekës Amë për të gjitha bibliotekat në gjuhën shqipe në Luginën e Preshevës. Kjo bibliotekë do ta grumbullonte, përpunonte, ruante, mbronte dhe jepte në shfrytëzim tërë materialin bibliotekar dhe arkivor të Luginës.

Formimin e Koleksioneve të Trashëgimisë dhe të Vendit në kuadër të Bibliotekës Rajonale, e cila do ta grumbullonte, përpunonte, ruante dhe mbronte gjithë materialin bibliotekar dhe arkivor të Luginës, dhe;

Themelimin e Shoqatës së Bibliotekarëve Shqiptarë të Luginës, i cili do të bashkëpunonte me simotrat në rajon në krijimin e sistemit të përbashkët bibliotekar informativ, përparimin e bibliotekarisë dhe shkollimin e kuadrove bibliotekare.

Të gjitha këto forma të propozuara duhet të sigurohen dhe aplikohen në nivele republikane, rajonale e komunale dhe të jepen me dispozita dhe marrëveshjeje ligjore.

BIBLIOTEKAT E BURGJEVE

Avdi Lakna*

Për këtë temë jam përcaktuar pasi fati e deshi që unë të përgatis dy biblioteka në dy burgjet më të mëdha të Kosovë në vitin 2006. Gjatë punës sime në këto dy burgje interesimi për lexim i kësaj pjese të shoqërisë më dha të kuptoj se është shumë e nevojshme një përkujdesje më e madhe edhe ndaj tyre. Roli i bibliotekës është shumë i madh në edukimin, përgatitjen dhe risocializimin e kësaj kategorie për shoqërinë dhe për familjen. Në dokumentet ndërkombëtare për bibliotekat, që nga fundi i shekullit të kaluar e deri në fillim të këtij shekulli, përmenden përdoruesit me shërbime të veçanta të cilët nuk kanë mundësi të kenë qasje të lirë në shërbime bibliotekare, prandaj u deshën forma të tjera të organizimit dhe krijimit të koleksioneve për të burgosurit. Kështu që Këshilli i Evropës / EBLIDA kërkon që shërbimet bibliotekare për personat me shërbime të veçanta të përgatitin akte

* Avdi Lakna është përgjegjës në Departamentin e Arsimimit Bibliotekar në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Kjo kumtesë është prezantuar më 17 prill 2008 në Bibliotekën Ndërkomunale të Gjilanit në sesionin me temën: "Bibliotekaria në Kosovë", gjatë Javës së Bibliotekës në Kosovë.

ligjore dhe nënligjore kundër diskriminimit të kësaj shtrese të komunitetit, ku bëjnë pjesë edhe të burgosurit.

Ideja e këtij punimi ishte që të përgatitet një projekt për një degë të bibliotekës ndërkomunale në qytetin i cili ka burgun me 400 të burgosur.

Ekipi i ekspertëve filloi punën për ndërtimin e koleksioneve bibliotekare për grupin e personave me shërbime të veçanta për të burgosurit. Obligimi i ekipit të ekspertëve është që t'u përmbahen rregullave - kritereve të përzgjedhjes së literaturës për shërbime me nevoja të veçanta për të burgosurit, e cila shërben për edukimin e kësaj shtrese të shoqërisë. Po citojmë udhëzuesin për biblioteka me shërbime të veçanta për të burgosurit, ku thuhet se "për çdo të burgosur është e obligueshme të sigurohen 20 tituj të materialit bibliotekar, ndërsa numri i përgjithshëm nuk guxon të jetë më i vogël se 2000 libra për një bibliotekë". Gjithashtu kërkohet që në përgatitjen e buxhetit vjetor të parashihet blerja e dy librave për një të burgosur[1]. Ndërsa nga stafi i burgut, e obligueshme është sigurimi i shtypit ditor dhe i revistave të ndryshme. Sipas statistikave të disa vendeve, del se për këtë shtresë të shoqërisë nuk ka përkujdesje të mjaftueshme, prandaj qëllimi i këtij udhëzuesi është planifikimi dhe vlerësimi i koleksioneve për të burgosurit. Seksioni i IFLA-as për persona me nevoja të veçanta është autorizuar edhe për bibliotekat e burgjeve, zhvillimin e shoqërisë dhe shërbimet qeveritare të kësaj shtrese e cila nuk ka mundësi të shfrytëzojë koleksionet në bibliotekat publike. Në rastet kur mungon biblioteka, udhëheqja e burgut është e detyruar që të sigurojë shërbime bibliotekare dhe literaturë të nevojshme duke e huazuar atë në bibliotekën publike ose në forma të tjera. Këshilli i përhershëm i IFLA-së, Seksioni për persona me shërbime të veçanta për bibliotekat e burgjeve, i themeluar më 1985, për pesë vjet radhazi punoi dhe përgatiti udhëzuesin për

1 Horvat, Aleksandra; Nebesny, Tatjana. Zatvorske knji□nice u Hrvatskoj.// Slobodan pristup informacijama, 2. i 3. okrugli stol: Zbornik radova / Uredile Belan – Simi?, Alemka i Horvet, Aleksandra. Zagreb: Hrvatsko knji□ni?arsko društvo, (2004). Str. 129-136.

bibliotekat e burgjeve. Gjatë kësaj periudhe ky grup punues organizoi dhe ndihmoi disa konferenca, një hulumtim të përgjithshëm për rëndësinë e bibliotekave për të burgosur. Ndërsa Frans E. Kaiser, 1995 ka përgatitur këshillat dhe udhëzimet për format e shërbimeve, personelit, sasinë, vlerësimin e koleksioneve, metodat e punës në bibliotekat e burgjeve si dhe financimin. Tani shoqëria moderne po zhvillon dhe përparon zbatimin e reformave ndaj kësaj shtrese të shoqërisë. Në zbatimin e ligjeve për të burgosurit, sipas kartës së OKB-ë mbi të drejtat e njeriut, ekziston një trend zhvillimi nga i cili përfitojnë të dënuarit, duke shfrytëzuar shërbimet e ofruara nga biblioteka. Disa dokumente të miratuara në nivel ndërkombëtar na shërbejnë si bazë për pasurimin e koleksioneve në burgje. Rekomandimet për shkollimin dhe edukimin e të burgosurve, të miratuara nga **Këshilli i Evropës në (Strasburg,1990),** përmbajnë edhe një kapitull për bibliotekat e burgjeve. Përmbajtja e këtyre rekomandimeve na udhëzon se duhet përmbushur me përpikëri standardet profesionale për bibliotekat e burgjeve, të cilat vlejnë edhe për gjithë komunitetin. Me këto biblioteka duhet të udhëheqë kuadri profesionist, i cili përmbush kriteret dhe nevojat e domosdoshme. Po ashtu të burgosurve duhet t'u mundësohen shërbime adekuate, ku do të organizoheshin aktivitete të ndryshme për mësim, shkrim dhe lexim[2]. **Manifesti për bibliotekat publike, sipas IFLA-së/UNESCO-së, më 1994** obligon bibliotekat publike që të jenë në shërbim të të burgosurve[3]. **Në këshillat për përdorues të përgatitur nga Këshilli Ndërkombëtar për Librin** (International Book Committee) dhe Nënkëshilli Ndërkombëtar i Botuesve (International Publishers Associations), të cilën e ofroi UNESCO thuhet se leximi është e drejtë universale[4]. **Në nenin 40- të të Kartës së KB mbi të drejtat e të burgosurve, më 1995 dhe sjelljes**

2 Citirano prema: Smjerenice za knji□nicne usluge za zatvorenike: URL: htt://www.hkdrustvo.hr/datoteke/304 (2008-03-10)

3 Po aty

4 Po aty

ndaj tyre thuhet se: „Çdo institucion duhet të ketë bibliotekën për të gjitha kategoritë e të burgosurve, të pajisur me koleksione të llojllojshme nga të gjitha fushat e edukimit, të burgosurit të nxiten dhe të shfrytëzojnë librin sa më tepër“[5].

Para se të fillohet me implementimin e projektit, duhet të kihet parasysh se kemi të bëjmë me një shtresë e cila ka nevoja të veçanta, prandaj duhet të ndërmerren hapa të kujdesshëm për ndërtimin e këtyre koleksioneve. Problemet qëndrojnë kur në mesin e të burgosurve ka të atillë që nuk dinë shkrim dhe lexim, kur ka komunitete të ndryshme, kur ka me të meta psikike, narkomanë etj. Obligimi ynë është që atyre t'u sigurojmë koleksione të zgjedhura që i përmbushin nevojat dhe dëshirat e tyre. Roli i bibliotekës në edukimin e të burgosurve është shumë i madh, prandaj në përzgjedhjen e literaturës duhet të konsultohet edhe stafi arsimor i cili edukon të burgosurit, stafi udhëheqës i burgut; duhet shikuar se lokali i bibliotekës a i përmbush kriteret e nevojshme për përdoruesit, a i plotëson kriteret për ndërtimin dhe vendosjen e koleksioneve në rafte sipas standardeve, a ka qasje të lirë për shfrytëzuesit etj. Para se të fillohet me ndërtimin e koleksioneve bibliotekare, duhet të ndërmerren edhe këto masa: Të mbështetemi në ligjin e bibliotekarisë, të konsultojmë Ministrinë e Drejtësisë, Departamentin për të Burgosurit, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Kulturës si dhe Bibliotekën Kombëtare, e cila sipas ligjit e ka përgjegjësinë kryesore në përparimin dhe zhvillimin e bibliotekarisë. Këto masa ndërmerren për të siguruar përkrahje materiale dhe politike për realizimin me sukses të projektit. Gjatë takimit me këto subjekte paraqitet projekti i cili elaborohet në detaje për ndërtimin e koleksioneve të bibliotekës së burgut, duke u mbështetur në rregullat dhe standardet e IFLA-së. Sipas teoricienit - E. Evans, ndërtimi i koleksioneve bibliotekare është proces mjaft i komplikuar dhe kërkon vlerësim, bashkëpunim me ekspertët e fushave të ndryshme për të përmbush kërkesat e komunitetit. Për ndërtimin e

[5] Po aty

koleksioneve janë disa faza: a). Planifikimi i pasurimit, b). Seleksionimi dhe përzgjedhja e koleksioneve, c). Procedimi i pasurimit.

Planifikimi i pasurimit: a) Kontaktohen botuesit, libraritë, panairet e librit, furnizuesit e librit, faqet elektronike etj. Nga ta kërkohet që të aplikojnë me oferta për ofrimin e literaturës së kërkuar për bibliotekën e burgut, e cila është përgatitur në detaje nga ekipi i ekspertëve; **b**) Nga ta kërkohet edhe literatura në gjuhët e komuniteteve pasi kjo është e garantuar sipas kartës së KB-ës për të drejtat e njeriut; **c**) Kërkohen revista të përzgjedhura, gazetat e përditshme, ilustrime të ndryshme, CD-ROM me filma edukativ dhe muzikë etj. Literatura e përzgjedhur duhet të jetë nga: beletristika, poezia, psikologjia, mendimi pozitiv, literatura referale, literaturë me këshilla mjekësore, literatura e mësimit dhe edukimit për të gjithë të burgosurit, fotografi të ndryshme, libra dhe ilustrime etj. Si përfundim koleksionet bibliotekare verifikohen, a kanë dëmtime, lëshime teknike, mungesa të faqeve, etj. Nëse konstatohet se ka lëshime, atëherë bëhen reklamime, ndërsa kur mungon ndonjë libër dhe kontraktuesi nuk mund ta sigurojë, duhet përgatitur edhe disederate për ata tituj . Pasi të kenë përfunduar të gjitha procedurat e pasurimit fillohet me finalizimin, përgatitjen e koleksioneve për përdorim nga lexuesit.

Literatura:

Horvat, Aleksandra; Nebesny, Tatjana. Zatvorske knji nice u Hrvatskoj.// Slobodan pristup informacijama, 2. i 3. okrugli stol: Zbornik radova / Uredile Belan-Simi?, Alemka i Horvat, Aleksandra. Zagreb: Hrvatsko knji ni?arsko društvo, (2004). Str. 129-136.

Gazeta zyrtare e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë. Viti. II/ nr. 15 (1 gusht 2007).

Smjerenice za knji ni?ne usluge za zatvorenike:URL: http://www.hkdrustvo.hr/datoteke/304 (2008-03-10)

LIBRARIES IN THE WEB

Karen Coyle*

http://www.oclc.org/reports/2005perceptions.htm



* Karen Coyle është konsultante për Bibliotekat Digjitale në Universitetin e Kalifornisë në SHBA. Ky abstrakt është përmbledhje e një artikulli më të gjerë të prezantuar më 18 prill 2008, në Prishtinë, në manifestimin Java e Bibliotekës në Kosovë.



-50% use library catalog at least once a year

2% begin their research in the library catalog

WHERE DO USERS START?

- INTERNET
- WEB SITES
- ONLINE BOOKSTORES

WHY DO THEY START THERE?

SAMPLE SEARCH:
LOLITA

Google

GOOGLE POINTS TO…

- WIKIPEDIA ENCYCLOPEDIA ARTICLE
- AMAZON BOOKSTORE
- INTERNET MOVIE DATABASE ENTRY
- GOOGLE BOOKS PAGE WITH DIGITAL VERSION
- NEWS SOURCES
- FAN SITES

Wikipedia



WIKIPEDIA HAS…

- SUMMARY OF THE TEXT
- LITERARY THEORIES
- LISTS EDITIONS
- LISTS MOVIES AND TV ADAPTATIONS
- HAS REFERENCES TO BOOKS AND ARTICLES
- LISTS ALL WORKS BY THE AUTHOR
- HAS LINKS TO LIBRARIES AND BOOKSTORES
- ALLOWS USER EDITING

Amazon

AMAZON HAS…

- MANY THINGS TO SELL
- REVIEWS (PUBLISHED OR ADDED BY USERS)
- LINKS TO ALL EDITIONS
- OTHER BOOKS YOU MIGHT LIKE TO BUY/READ
- THE ABILITY TO SEARCH WITHIN THE TEXT
- RATINGS
- SUBJECT HEADINGS TO SEARCH ON
- USER TAGS

Google book search



GOOGLE BOOKS HAS …

- SUMMARY
- SEARCH WITHIN TEXT
- SOME SNIPPETS OF TEXT
- LINKS TO REVIEWS
- BOOKS THAT CITE THE BOOK
- LINKS TO BOOKSTORES, LIBRARIES, AND WEB PAGES
- RELATED BOOKS

Library catalog (Aleph)



Library Catalog (Innovative Interfaces)



OTHERS

• RICH DATA, MANY LINKS
• EVALUATIVE INFORMATION (REVIEWS, RANKING)
• USER INTERACTION
• LINKS TO OTHER SERVICES (BOOKSTORES, WEB SITES, LIBRARIES)
• SEARCH WITHIN TEXT

• MEDIOCRE BIBLIOGRAPHIC DATA

LIBRARIES

• HIGH QUALITY BIBLIOGRAPHIC DATA
• LIBRARY HOLDINGS
• AVAILABILITY

• FEW LINKS TO WEB RESOURCES
• NO WAY TO LINK INTO LIBRARY DATA FROM WEB
• NO USER PARTICIPATION



LIBRARIES CAN DO BETTER!

RE-DEFINING THE LIBRARY CATALOG





NEW GENERATION LIBRARY CATALOG

- MORE THAN JUST A FINDING LIST FOR LIBRARY HOLDINGS
- IS NEVER A DEAD END (ALWAYS LINKS TO OTHER RESOURCES)
- ALLOWS USER INTERACTION
- HAS, OR PULLS IN, A WIDE VARIETY OF INFORMATION
- HELPS USERS EVALUATE RESOURCES

WHERE WILL WE GET THE DATA?

LIBRARIES HAVE THE DATA

WORLDCAT IDENTITIES

- DATA-MINED FROM LIBRARY DATA IN WORLDCAT DATABASE
- SHOWS BOOKS BY AND ABOUT A PERSON
- INDICATES THE PERSON'S LITERARY OR OTHER IMPORTANCE
- LISTS TRANSLATIONS
- HAS RELATED AUTHORS
- LINKS TO LIBRARIES, WIKIPEDIA
- SHOWS A "TAG CLOUD" (TOPICS AND THEIR FREQUENCY OF USE)

GETTING LIBRARY DATA INTO THE WEB







EXAMPLE: OPEN LIBRARY

A PROJECT OF THE INTERNET ARCHIVE

Open Library: one web page per book

http://demo.openlibrary.org



Book page

Author page



THE OPEN LIBRARY HAS…

- ONE WEB PAGE PER BOOK AND ONE WEB PAGE PER AUTHOR
- ANY WEB SITES CAN LINK TO THESE PAGES
- REVIEWS, COVERS, ETC.
- LINKS FROM WIKIPEDIA
- LINKS TO BOOKSTORES AND LIBRARIES
- LINKS TO DIGITIZED BOOKS (GOOGLE AND OPEN
- CONTENT ALLIANCE)
- USERS CAN EDIT AND ADD CONTENT

OPEN LIBRARY DATA

- LIBRARY CATALOGING
- PUBLISHER DATA (ONIX RECORDS)
- DATA TAKEN FROM AMAZON

NEXT GENERATION CATALOG REQUIRES NEXT GENERATION CATALOGING

NEXTGEN CATALOG(ING)

- "WEB-IFY" LIBRARY DATA
- MAKE LIBRARY DATA AVAILABLE TO ONLINE SERVICES
- ALLOW RE-USE OF LIBRARY BIBLIOGRAPHIC DATA
- TAKE LIBRARY DATA TO THE USER

STEPS TO THE FUTURE

- NEW CATALOGING RULES ARE BENG DEVELOPED (RDA – RESOURCE DESCRIPTIONAND ACCESS)
- THE LIBRARY COMMUNITY IS CONTEMPLATING CHANGES IN WORK-FLOW AND SHARING
- WORK IS BEING DONE TO RE-DEFINE LIBRARY DATA, COMPATIBLE WITH THE SEMANTIC WEB
- OPEN SOURCE SOFTWARE IS BEING CREATED AND USED

LINKS

- RESOURCE DESCRIPTION AND ACCESS
- HTTP://WWW.COLLECTIONSCANADA.GC.CA/JSC/RDA.HTML
- FUTURE OF BIBLIOGRAPHIC CONTROL
- HTTP://WWW.LOC.GOV/BIBLIOGRAPHIC-FUTURE/
- DUBLIN CORE/RDA TASK FORCE
- HTTP://DUBLINCORE.ORG/DCMIRDATASKGROUP/FRONTPAGE

TRENDS IN LIBRARY SYSTEMS

Karen Coyle*

Main trends

- Separation of the user interface from library management functions
- New user interfaces, with new user services
- Open Source systems
- Increased interaction with Web services
- Change from library of things to library of services

History

- 1960-1970 Automated circulation systems



History

- 1960-1970 Automated circulation systems

* Karen Coyle është konsultante për Bibliotekat Digjitale në Universitetin e Kalifornisë në SHBA. Ky abstrakt është përmbledhje e një artikulli më të gjerë të prezantuar më 18 prill 2008, në Prizren, në manifestimin Java e Bibliotekës në Kosovë.

• 1970-1980 Cataloging and Card production

History

• 1960-1970 Automated circulation systems
• 1970-1980 Cataloging and Card production
• 1980-1990 Online catalogs, acquisitions and serials systems







ILS Advantages

• All data available to all applications
• Updates have to be done only once in one database
• One vendor for all applications

ILS Dis-advantages

• User interface and library management functions compete for resources (search, display)
• Updating is complex because there can be multiple users of a record at a time
• User interface and library management compete at a design level



Advantages

- Less competition for resources in the system
- User interface can change in ways that would not work with library management functions
- User interface can use more nimble, web-oriented technology

Disadvantages

- Library pays for ILS plus a new user interface
- User interface may come from a different vendor
- More hardware and software always means more work

The new user interface...

- ... looks more like a "regular" web site than a catalog
- ... has new functions, like facets, tags, suggested reading
- ... can be outsourced (run by a vendor) because it is separate






SEARCH TRLN
venice
in Title
Search
Current Search
Refine Your Search
The merchant of Venice
Tropic of Venice
No vulgar hotel : the desire and pursuit of Venice
Othello, the Moor of Venice : texts and contexts
Marco Polo : from Venice to Xanadu


SEARCH TRLN
Endeca
http://endeca.com


HKUST LIBRARY CATALOG (NEXT-GENERATION)
BETA
Library Home Page
Searching
Marco Polo : from Venice to Xanadu


HKUST LIBRARY CATALOG (NEXT-GENERATION)
BETA
Library Home Page
Scriblio
http://about.scriblio.net
- based on WordPress blogging software
http://wordpress.org
! Both are free !


UNIVERSITY OF WASHINGTON Libraries
Off-Campus Access
Ask Us
Your Library Account
Survey - Your Voice Counts
Home
Search
You are not signed in (Sign In to WorldCat or Register)
Search: venice
Libraries Worldwide (WorldCat)
Go
Advanced Search
Search results for 'venice' limited to Libraries Worldwide (WorldCat)
Sort by: Relevance
Refine Your Search
Results 1-10 of about 67,313 (1.05 seconds)
« First ‹ Prev 1 2 3 Next ›
Author
Format
Select All
Clear All
Save to: [New List]
Save
1. The merchant of Venice.
by William Shakespeare; William Lyon Phelps
Language: English Type: Book
Publisher: New Haven, Yale University Press, [etc.] 1923.
Held by: University of Washington Libraries
2. "Venice"
by J Langenbach
Language: English Type: Article
Publication: NEW YORKER--NEW YORKER MAGAZINE INCORPORATED (July 2, 2007): 84-84
Database: British Library Serials
Held by: University of Washington Libraries
3. The tragedy of Othello, the Moor of Venice.
by William Shakespeare; Tucker Brooke; Lawrence Mason
Language: English Type: Book
Publisher: New Haven, Yale University Press; London, G. Cumberlege, Oxford University Press [1947]
Held by: University of Washington Libraries
4. Venice
by Aubrey Menen; Ernst Haas
Language: English Type: Book
Publisher: Amsterdam ; Time-Life Books, ©1975.
Held by: University of Washington Libraries


The merchant of Venice,
by William Shakespeare; William Lyon Phelps
Type: Book; English
Publisher: New Haven, Yale University Press; [etc.] 1923.
Editions: 1291 Editions
OCLC: 2554583
Related Subjects: Jews -- Italy -- Drama. Venice (Italy) -- Drama. Moneylenders -- Drama.
Citations: Cite this Item | Export to EndNote | Export to RefWorks
University of Washington Libraries owns this in other formats: Cassette tape | LP recording | Microform
Get this Item
Request Item
University of Washington Libraries (4 of 4 copies available)
Summit Libraries (13 of 14 copies available)
Get It
Request Item
Save It
Add This Page to Favorites
Save to: [New List]
Save
Add to It
Review this Item
Edit Public Notes
Share It
Link to this Page
Libraries
Details
Subjects
Editions
Reviews
Enter Location Information: seattle, wa
98101 Seattle, WA
Go
Enter postal code, state, province or country
Displaying libraries 1-10 out of 4391 for all 1291 editions
98101 Seattle, WA
« First ‹ Prev 1 2 3 Next › Last »
Showing libraries that own: All Editions | Just this Edition
Narrow Your Results by Format: Display All Formats
Seattle Central Community College Seattle, WA 98122 United States 1 mile
Book
Services: Library Information
Seattle Public Library Seattle, WA 98104 United States 1 mile


WorldCat Local
http://www.oclc.org/worldcatlocal/


Get this Item
Request Item
University of Washington Libraries (4 of 4 copies available)
Summit Libraries (13 of 14 copies available)
Get It
Request Item
Save It
Add This Page to Favorites
Save to: [New List]
Save
Add to It
Review this Item
Edit Public Notes
Libraries
Details
Subjects
Editions
Reviews
Enter Location Information: albania
Go
Enter postal code, state, province or country
Here are the closest areas that have libraries holding the specified item:
Greece
Bulgaria
Italy
Slovenia
Czech Republic
Switzerland
Germany
Ukraine
Turkey
France

Open Source ILSs

• Koha http://www.koha.org
available from Liblime http://liblime.com

part of open source program for Electronic
Information for Libraries http://www.eifl.net







Open Source ILSs

• Koha http://www.koha.org
available from Liblime http://liblime.com
• Evergreen http://open-ils.org







Making use of networked resources





From a library of things to a library of services

New library system manages things, but makes more services possible

Services (Web and others)

- Links from catalog to Web sites (Amazon, Wikipedia)
- Addition of features from Web sites to catalog (covers, tags, reviews)
- Links to full text (Google, or via OpenURL)
- Interlinks to Courseware (Blackboard, etc.)
- Creation of electronic reserves for college classes

JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË

LIBRARY WEEK IN KOSOVA

14-19 PRILL - APRIL 2008

Botues:
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës
Prishtinë
2009

Shtypi
"Prograf"
Prishtinë

Katalogimi në botim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

027.54(496.51)(063)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës (Prishtinë)
Java e Bibliotekës në Kosovë = Library Week in Kosova : 14-18 Prill = April 2008 / [Kryeradaktor i botimeve Sali Bashota]. - Prishtinë : Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, 2009. - 176 f. ; 21 cm. - (BKUK Botime të veçanta ; 15 : Java e Bibliotekës në Kosovë ; 6)

1. Bashota, Sali

ISBN 978-9951-13-038-7